



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KESHILLI I MINISTRAVE

STRATEGJIA

PËR ZBATIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE 2010 – 2015

PËRGATITUR:

Nën kujdesin e:	Grupit Teknik të Punës të ngritur me Urdher të Kryeministrit Nr. 40, datë 18.03.2009 nën drejtimin e Zevendes Ministrit të Integritimit Dr.Edmond HOXHA
Nga Ekspertë e huaj	Lukáš LORENC , Ekspert Ligjor Pascal PHLIX , Përfaqësues i Zyrës Europiane Të Patentave
Në konsultim me:	Grupin Keshillimor të ngritur me Urdher të Ministrit të Integritimit dhe me Koordinatorin Nacional të IPA-s rajonale, Z.Andrea Kushti
Përshtati formatin	Dokumenti u përshtat në formatin zyrtar të Strategjive nga Enton DERRAJ, Ilia Paluka, Ekspertë

Ekspertiza e huaj u be e mundur nga Programi Rajonal IPA – 2007, “Për të drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale në Ballkanin Përendimor dhe Turqi”. Projekti u financua nga BE dhe u menaxhua nga Drejtoria e Përgjithëshme për Zgjerimin e Implementuar nga Zyra Europiane e Patentave.



Ky dokument është hartuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Mendimet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë në asnjë mënyrë opinionin zyrtar të Bashkimit Europian apo të Zyrës Europiane të Patentave

TIRANË Korrik 2010

LISTA E PLOTË E KONTRIBUESVE

Grupi Teknik i Punës:

Nr.	Emri Mbiemri	Institucioni
1.	Dr. Edmond Hoxha	Zevendes Ministër. Ministria e Integritimit
2.	Manjola Duli	Keshilli i Ministrave, Departamenti i Strategjive
3.	Safet Sula	Drejtor i Përgjithshëm i DPPM, Ministria e Ekonomise Tregtisë dhe Energjetikes,
4.	Andrea Kushti	Koordinatori Nacional i IPA-s Rajonale, Drejtor Mbështetes, DPPM
5.	Arian Rukaj	Ish Drejtor i Përgjithshëm, DPPM, Ministria e Ekonomise Tregtisë dhe Energjetikes,
6.	Anila Jani	Drejtor i Mbikqyrjes se Tregut, Ministria e Ekonomise Tregtisë dhe Energjetikes
7.	Nikoleta Gjordeni	Drejtor i ZSHDA, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportëve,
8.	Mirlinda Çollaku	Përgjegjëse Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë, ZSHDA
9.	Adriana Xhuveli	Drejtor i Tregut të Brendshëm, Ministria e Integritimit
10.	Jorida Shtaj	Përgjegjëse e Sektorit të Çështjeve të Pronësisë Intelektuale, Ministria e Integritimit
11.	Rezarta Bitri	Ministria e Drejtësisë
12.	Denada Koçaj	Specialistë në Drejtorinë e Kodifikimit, Ministria e Drejtësisë
13.	Ervin Doci	Specialist në Drejtorinë e Politikave Makroekonomike, Ministria e Financave
14.	Ervina Domi	Drejtorë e Drejtorisë Juridike, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
15.	Ali Azizaj	Inspektor Tatimor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
16.	Idajet Faskaj	Specialist, Drejtoria Kundër Krimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
17.	Giselda Metaliaj	Përgjegjëse Sektori, KKRT

Institucione të tjera pjesëmarrëse në takime të IPR-se

Nr.	Emri Mbiemri	Institucioni
18.	Mark Reilly	EUD
19.	Pascal Phlix	Përfaqësues i Zyrës Europiane të Patentve
20.	Lucas Lorenc	Ekspert ligjor
21.	Ndricim Mehmeti	Përgjegjës Sektori për arsimin parauniversitar, MASH
22.	Naim Aliaj	Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia A.K.D.I.E
23.	Eduard Buda	Drejtor Juridik, A.K.D.I.E
24.	Idar Bistri	Drejtor Juridik, Agjencia ALBAUTOR
25.	Alban Beqaj	Drejtor, Agjencia A.M.I
26.	Ador Koleka	Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë, Shkolla e Magjistraturës
27.	Irena Malolli	Drejtor Juridik, AKSHI
28.	Enkeleda Peka	Specialist, Drejtoria Juridike, AKSHI
29.	Ervin Karanxha	Prokuror, Prokuroria e Rrethit Tiranë
30.	Illir Zhilla	Kryetar i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
31.	Krenar Loloçi	Avokat, Loloçi&Associatës
32.	Gentian Uruçi	Specilist, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë
33.	Sonila Meco	Përgjegjëse Sektori, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë
34.	Floreta Luli-Faber	Drejtorë Ekzekutive, Dhoma Amerikane e Tregtisë
35.	Arsen Kurti	Drejtor Ekzekutiv, Microsoft Tiranë
36.	Alban Ruli	Avokat, Drakopoulos Law Firm
37.	Ismail Beka	Zv.Drejtor, GTZ
38.	Adam Lazoëski	Legal Expert, SMEI I+II
39.	Alba Jorganxhi	Asistente Ligjore, OSCE

Lista e Grupit Keshillimor sipas Urdherit të Ministrisë të Integritimit

Nr.	Emri Mbiemri	Institucioni
40.	Xhafer Dobrusha	Konfederata e Sindikatave të Arsimit
41.	Adriana Berberi	Universiteti Marin Barleti
42.	Përparim Hoxha	Universiteti Politeknik i Tiranës
43.	Skëndër Kaçubi	Fakulteti i Drejtësisë
44.	Eduart Buda	Agjencia AKDIE
45.	Alban Beqa	Agjencia AMI
46.	Idar Bistri	Agjencia Albautor
47.	Pirro Milkani	Agjencia FMAA
48.	Dritan Shutina	Co-Plan
49.	Illir Zhilla	Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
50.	Krenar Loloçi	Studio Ligjore Loloci & Associatës

51.	Alban Ruli	Studio Ligjore Drakopoulos
52.	Sulo Hadëri	Universiteti Tiranës, Fakulteti Ekonomik
53.	Remzi Lani	Instituti i Medias
54.	Ermal Hasimja	Universiteti European i Tiranës
55.	Floreta Luli-Faber	Dhoma Amerikanë e Tregtisë

PËRMBAJTJA

STRATEGJIA PËR ZBATIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

AKRONIMET	6
Hyrje	7
KAPITULLI I KUSHTET AKTUALE	9
1.1. Konteksti Rajonal dhe Ndërkombëtar	9
1.2. Konteksti Ekzistues Ligjor dhe Institucional në Shqipëri	10
1.3. Rolet dhe Përgjegjësitë e Institucioneve	11
1.3.1. DPPM	11
1.3.2. ZSHDA	12
1.3.3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	13
1.3.4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	14
1.3.5. Ministria e Drejtësisë	14
1.3.6. Shkolla e Magjistraturës	15
1.3.7. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit	15
1.4. Publiku dhe të Drejtat e Autorit	15
1.5. Përfundime të Kuadrit Ekzistues	16
KAPITULLI II VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	18
2.1. Vizioni i Qeverisë Shqiptare	18
2.2. Prioritetet Strategjike	18
2.3. Objektivat Strategjike	19
KAPITULLI III POLITIKAT	20
3.1. Parime të përgjithshme	20
3.2. Politikat	20
3.2.1. Përmirësimi dhe Konsolidimi i Kuadrit Ligjor	21
3.2.2. Forcimi dhe Zhvillimi i Institucioneve	22
3.2.2.1. DPPM	22
3.2.2.2. ZSHDA	27
3.2.2.3. Agjencitë e Administrimit Kolektiv	30
3.2.2.4. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	31
3.2.2.5. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	33
3.2.2.6. Ministria e Drejtësisë	34
3.2.2.7. Prokuroria	35
3.2.2.8. Shkolla e Magjistraturës	35
3.2.2.9. Inspektoriati I Tregut për Pronësinë Intelektuale	36
3.2.2.10. Ministria e Arsimit	36
3.2.2.11. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit	38
3.2.2.12. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	38
3.2.2.13. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	38
3.2.2.14. Zyrat e Liçencimit	38
3.2.2.15. Ambasadat e Shteteve të Huaja	39

3.2.2.16.	Dhomat e Tregtisë / Bashkëpunimi i Dhomave të Tregtisë	39
3.2.3.	Bashkëpunimi dhe Bashkërendimi i Institucioneve	39
3.2.4.	Ndërgjegjësimi i Publikut	40
KAPITULLI IV	LLOGARIDHËNIA & MONITORIMI	42
KAPITULLI V	PLANI I VEPRIMIT	43
	Plani i veprimit	44
KAPITULLI VI	ANEKSE	50
ANEKS 1.	Kuadri kombëtar ligjor për PI dhe <i>Acquis të BE-së</i>	50
ANEKS 2.	Standardet në Vendet Anëtare/Kandidate të BE-së: Eksperienca ne Çeki, Rumani & Kroaci	52

AKRONIMET

STRATEGJIA PËR ZBATIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

ZSHDA	Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit
MK	Markë Komunitare
KE	Komisioni European
ECJ	Gjykata Europiane e Drejtësisë
EPD	Dokumenti i Partnëritetit European
EPC	Konventa Europiane në fushën e Patentave
ZEP	Zyra Europiane e Patentave
BE	Bashkimi European
DPPM	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
PI	Pronësi intelektuale
IT	Teknologjia e informacionit
LAN	Rrjet lokal
MIE	Ministria e Integritit European
AKTI	Agjencia Kombëtare e Teknologjisë së Informacionit
KKRT	Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit
PKZMSA	Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
OHIM	Zyra për Harmonizimin e Tregut të Brendshëm
FZ	Fletorja Zyrtare
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
TRIPS	Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale
WIPO	Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale
PATLIB	Qendrat e Informacionit per Patentat

HYRJE

STRATEGJIA PËR ZBATIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

Zbatimi i së drejtës në lidhje me mbrojtjen e pronësise intelektuale, është një element themelor për zhvillimin e konkurrencës së rregullt dhe të drejtë në çdo aspekt të jetës sociale dhe ekonomike të një vendi. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, në nenin 27 të saj specifikon se: “Gjithkush ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale, që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe artistike, autor i të cilave është ai vetë”

Pirateria, që nënkupton prodhimin, shpërndarjen, shitjen si dhe emetimin ilegal i materialeve që janë subjekt i marrëveshjeve ndërkombëtare mbi mbrojtjen e pronësise intelektuale – është një formë e padrejtë e konkurrencës. Pirateria i dëmton interesat e autorëve dhe pronarëve tjerë të të drejtave, rrezikon të provokojë kundërmasa ndërkombëtare në tregti, vendos në një pozitë jo të favorshme ekonomike ata të cilët veprojnë në përputhje me ligjin dhe pengon zhvillimin normal të ekonomisë së tregut.

Shqipëria është shumë e vetëdijshme se zbatimi efikas i të drejtave të pronësise intelektuale është një element thelbësor për progresin e mëtejshëm social ekonomik si dhe rritjen e nivelit të konkurrueshmërisë së vendit në tregun ndërkombëtar dhe garantimin e një mjedisi konkurrence të drejtë në tregun kombëtar. Ajo, kontribuon në krijimin e kushteve optimale për thithjen e investimeve të huaja në vend si dhe është një gur themeli në procesin e integritit të tij në Bashkimin Europian.

Strategjia Kombëtare 2010 – 2015 për zbatimin e të drejtave të pronësise intelektuale në Shqipëri është pikerisht, një nga gurët e rëndësishëm të rrugës drejt integritit. Përgatitja e saj është bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, në analizën e kuadrit ligjor ekzistues si dhe masave administrative dhe institucionale të ndërmarra në vend lidhur me këtë çështje. Përfundimet e strategjisë janë përshtatur me detyrimet që ka Shqipëria lidhur me të drejtat e pronësise intelektuale në kuader të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe integritit në Bashkimin Europian, duke identifikuar në këtë mënyrë objektivat dhe masat e nevojshme që duhen marrë nga Shqipëria lidhur me këtë komponent në të ardhmen.

Në këtë dokument, “pronësia intelektuale” (PI) nënkupton jo vetëm patentat, dizenet industriale, modelet e përdorimit, markat tregtare, topografinë e gjysmëpërcjellësve dhe treguesit gjeografikë, por edhe të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, megjithëse kjo është trajtuar shpesh si një kategori e veçantë e ligjit.

Strategjia mbulon një periudhë pesë vjeçare, 2010 - 2015. Kjo periudhë kushtëzohet nga situata aktuale në fushën e pronësise intelektuale, e cila kërkon masa të shpejta por komplekse në mënyrë që të reformohet me efikasitet pothuajse i gjithë sistemi, me përjashtim të pjesëve kryesore të kuadrit ligjor që konsiderohet se janë pothuajse të harmonizuara me *Acquis te BE-së*.

Eksperiencia e huaj tregon se, që sistemi i PI-së të funksionojë në mënyrë efikase duhet të plotësohen shumë kushte, ndërkohë që efikasiteti i përgjithshëm i të gjithë sistemit ndikohet

ndjeshëm nga elementet e tij më të dobët. Këta elemente më të dobët duhet të trajtohen me prioritet nëpërmjet strategjisë.

Strategjia në vazhdim është bazuar në eksperiencën çeke, të mbështetur nga një studim afatgjatë dhe i thellë i situatës në fushën e PI-së në vende të tjera europiane, në marrëveshje me partnerët shqiptarë. Për këtë arsye, sistemi i rekomanduar mund të ndryshojë deri diku për sa i përket kërkesave të institucioneve të përfshira.

KAPITULLI I

KUSHTET AKTUALE

1.1. Konteksti Rajonal dhe Ndërkombëtar

Për sa i përket të drejtës së autorit, legjislacioni ekzistues i referohet dispozitave ligjore europiane (Acquis të BE'së) të mëposhtme:

- Direktiva **93/83/KEE** datë 27 shtator 1993 “Për koordinimin e rregullave për të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të që zbatohen në transmetimet satëlitore dhe ritransmetimet kabllorë – *Celex nr. 31993L0083/ Fletorja zyrtare 1993L248/15.*
- Direktiva **2001/84/KE** e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 27 shtator 2001 “Për të drejtën e rishitjes në dobi të autorit të një vepre arti origjinale” – *Celex nr. 32001L0084/ Fletorja zyrtare 2001 L 272/32.*
- Direktiva **2006/115/KE** e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 12 dhjetor 2006 “Për të drejtën e qirasë dhe huazimit si dhe për disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale” (version i kodifikuar i 92/100/KEE) – *Celex nr. 32006L0115/ Fletorja zyrtare 2006 L 376/28.*
- Direktiva **2006/116/KE** e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 12 dhjetor 2006 “Për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të” (version i kodifikuar i 93/98/KE) – *Celex nr. 32006L0116/ Fletorja zyrtare 2006 L372/12.*
- Direktiva **96/9/KE** e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 11 mars 1996 “Për mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave” – *Celex nr. 31996L0009/ Fletorja zyrtare 1996 L 77/20.*
- Direktiva **2009/24/KE** e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 23 prill 2009 “Për mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike” – *Celex nr. 32009L0024/ Fletorja zyrtare 2009 L 111/16.*

Ndërkohë, Shqipëria ka aderuar në të gjitha konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen me të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale. Dy nga dokumentet kryesore që përcaktojnë prioritetet strategjike në këtë fushë janë:

1. Dokumenti i Partnëritetit Europian (EPD);
2. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), e cila është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin nr. 9590 datë 27 Korrik 2006 “ Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare” (*Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë nr. 87 datë 14.08.2006; i hyrë në fuqi më 14 Gusht 2006, fq. 2976.*)

Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA), i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 463 datë 5 korrik 2006 (*Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë nr. 80 datë 2.08.2006, fq. 2409-2414*), në përputhje me nenin 73 dhe Shtojcën V të MSA-së (*Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë nr. 87 datë 14.08.2006, fq. 3028*) parashikon një listë me Konventa shumëpalëshe në të cilat janë palë Shtetet Anëtare të BE-së dhe në të cilat Shqipëria synon të bëhet palë.

Gjithashtu, këto dokumente parashikojnë që jo më vonë se katër vjet pas hyrjes në fuqi të MSA-së, Shqipëria duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar dhe për të siguruar një nivel mbrojtjeje për të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, të ngjashëm me atë që është arritur nga Shtetet Anëtare të BE-së, duke përfshirë mjetet efikase për zbatimin e këtyre të drejtave.

1.2. Konteksti ekzistues ligjor dhe institucional në Shqipëri.

Aktualisht, të drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale në Shqipëri trajtohen nëpërmjet Ligjit nr. 9947, datë 7 Korrik 2008 “Për Pronësinë Industriale”, si dhe Ligjit nr. 9380 dt.28 Prill 2005: “Për të Drejtën e Autorit e të Drejta të Tjera të Lidhura me Të”.

Ndërkohë, Institucionet kryesore përgjegjëse për administrimin dhe monitorimin e këtyre të drejtave janë:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM)
2. Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA)
3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH)
4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD)

Ligji “Për Pronësinë Industriale” përfshin jo vetëm rregullimin ligjor të të gjitha institucioneve industriale ligjore por edhe çështjet që lidhen me shkeljen e këtyre të drejtave, çështjet procedurale që kanë të bëjnë me proceset gjyqësore duke përfshirë të drejtën e marrjes së informacionit, rregullimin e urdhrave paraprakë dhe masave në pikat kufitare, regjistrimet e patentave europiane të shtrira në Shqipëri, çertifikatat për mbrojtjen shtesë për agjentet e mbrojtjes së produkteve farmaceutike dhe bimëve,

Ligji “Për Pronësinë Industriale” përcakton pozicionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM), strukturën e brendshme të saj si dhe çështjet që lidhen me përfaqësuesit e autorizuar për të vepruar në çështjet e patentave dhe markave.

Ndërkohë, në mbështetje të Ligjit “Për të Drejtën e Autorit e të Drejta të Tjera të Lidhura me Të”, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 232 datë 19 Prill 2006: “Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit”. Kjo Zyrë është institucioni përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri. Gjithashtu, në iniciativat e reja ligjore përmendet procesi për përgatitjen e Ligjit i ri për të drejtën e autorit, nëpërmjet mbështetjes së vazhdueshme të ekspertëve të Bashkimit Europian dhe të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO). Hartimi i këtij Ligji po kryhet duke marrë në konsideratë përafrimin me Direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2000/48/KE, datë 29 Prill 2004, për zbatimin e plotë të të drejtave të pronësisë intelektuale.

Në Aneks 6.1 paraqitet në mënyrë të përmbledhur i gjithë kuadri legjislativ ekzistues që adreson çështjet e pronësisë intelektuale në Shqipëri dhe të drejtave të autorit.

1.3. Rolet dhe Përgjegjësitë e Institucioneve

1.3.1.DPPM

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe e Markave (DPPM) i ka filluar funksionimin të saj që në Mars të vitit 1993. E themeluar me vendim të Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë, ajo njihet si Zyra Shqiptare e Patentave. Në vitin 2000, DPPM-ja si fillim ishte një institucion qëndror publik i varur drejtpërdrejt nga Këshilli i Ministrave, siç parashikohet nga Dispozita e Qeverisë nr. 313 datë 13 Qershor 2000. Sipas Ligjit nr. 9525 datë 25 Prill 2006, DPPM-ja u shndërrua në një institucion publik nën varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës. Përmirësimi i mëtejshëm i rregullave procedurale në sigurimin e mbrojtjes ligjore industriale u ushtrua me Ligjin nr. 9947, datë 7 Korrik 2008.

Misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave¹ është të forcojë mbrojtjen e pronësisë industriale brenda territorit shqiptar nëpërmjet njohjes dhe/ose regjistrimit të këtyre të drejtave dhe nëpërmjet krijimit dhe organizimit të regjistrave të të drejtave në fuqi në Shqipëri. Drejtoria i ushtron kompetencat e saj nëpërmjet instrumenteve dhe mjeteve të mëposhtme:

- mbështetja e iniciativave që synojnë përmirësimin e legjislacionit të zbatueshëm në fushën e të drejtave të pronësisë industriale;
- mbështetja e iniciativave që synojnë aderimin e Shqipërisë në traktatet dhe konventat ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale;
- mbështetja e iniciativave që synojnë përmirësimin e bashkëpunimit midis institucioneve që marrin pjesë në mbrojtjen e pronësisë industriale;
- krijimi i një sistemi efikas për njohjen dhe regjistrimin e të drejtave të pronësisë industriale sipas rregulloreve në fuqi;
- mbështetja e fushës së të drejtave të pronësisë industriale dhe të drejtave të tjera që lindin prej kësaj, duke përfshirë rëndësinë e respektimit të këtyre të drejtave në sektorin e industrisë dhe sektorë të tjerë;
- sigurimi i kapaciteteve të nevojshme administrative dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm në këtë fushë;
- administrimi i regjistrave të hapur për publikun në lidhje me të drejtat e pronësisë industriale dhe botimi i të dhënave kyç në buletin periodik;
- krijimi i parakushteve dhe negocimi i marrëveshjeve dypalëshe për bashkëpunimin me autoritetet homologë të përfshirë në fushën e mbrojtjes së pronësisë industriale;
- sigurimi dhe organizimi i aktiviteteve të departamentit të apelit në përputhje me rregullat e brendshme;
- mbrojtja e mendimeve të Drejtorisë në çështjet gjyqësore dhe proceset e zhvilluara në institucionet e arbitrazhit duke përfshirë procedurat e gjykatës;
- organizimi i provimeve për avokatet e patentave dhe administrimi i listës së tyre.

Që nga viti 2009, DPPM-ja përdor sistemin e bazës së të dhënave për pronësinë industriale IPAS (Industrial Property Automated System), të instaluar nga WIPO në vitin 2006 që aplikimet ndërkombëtare për regjistrimin e markave të regjistruhen në mënyrë elektronike sipas Traktatit të Madridit dhe Protokollit të Madridit. Zbatimi i IPAS ka përshpejtuar përpunimin e aplikimeve dhe ka përmirësuar saktësinë e të dhënave në lidhje me subjektet e pronësisë industriale, gjë që është e rëndësishme si për proceset e zhvilluara përpara DPPM-

¹ Për me shume informacion shiko: www.alpto.gov.al

së, ashtu edhe për publikun në përgjithësi dhe, në veçanti, për zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale. Ai mundëson gjithashtu një qarkullim elektronik të të dhënave në mbështetje të botimit të Buletinit në version elektronik në faqen e internetit të DPPM-së..

1.3.2. ZSHDA

Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA) është një institucion qëndror, person publik juridik, i ngritur nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportëve për të përmbushur detyrimet e Shqipërisë në fushën e të drejtave të autorit dhe zbatimit të tyre. Zyra është zhvilluar si rezultat i nevojës emergjente në luftën kundër piraterisë dhe shkeljes së pronësisë intelektuale që ekziston në Shqipëri. Ngritja e Zyrës ishte gjithashtu një detyrim që rrjedh nga neni 73 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, në të cilin palët konfirmojnë rëndësinë e sigurimit të nivelit të posaçëm të mbrojtjes dhe vendosjes së të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri në nivel të ngjashëm me atë të Bashkimit Europian. Sipas kësaj Marrëveshjeje parashikohet që Shqipëria dhe palët nënshkruese ta përmbushin këtë detyrim për një periudhë katër vjeçare.

Kompetencat e (ZSHDA) janë përcaktuar sipas Vendimi nr. 232 të Këshillit të Ministrave. Një nga kompetencat kryesore të Zyrës lidhet me regjistrimin dhe zbatimin e predispozitave ligjore për të drejtën e autorit. Funkcionet e Zyrës përqëndrohen në:

- ndërgjegjësimin e publikut rreth çështjeve të përgjithshme të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, në bashkëpunim me një sërë organesh të pushtetit qëndror;
- monitorimin e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të;
- ngritjen e një sistemi të përshtatshëm të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit.

Roli i ZSHDA-së si organ arbitrazhi dhe vendimmarrës është i rëndësishëm edhe në aspektin e funksionimit të agjencive të administrimit kolektiv dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të tyre me përdoruesit e produkteve të pronësisë intelektuale (produkte të mbrojtur nga e drejta e autorit). “Administrimi kolektiv” është ushtrimi i të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të nga ana e agjencive, të cilat veprojnë në interes dhe në emër të mbajtësve të të drejtave. Sipas ligjit shqiptar për të drejtën e autorit. Agjencitë e Administrimit Kolektiv të së Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Lidhura me Të janë organizata jo fitimprurëse, të licencuara nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportëve me propozim të Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit. Deri me tani, janë licencuar 4 Agjenci, të listuara si më poshtë:

- Agjencia e Administrimit Kolektiv të së Drejtës së Autorit “ALBAUTOR” – në fushën e muzikës dhe regjistrimeve mekanike;
- Agjencia e Administrimit Kolektiv të së Drejtës së Autorit “FMAA” – për mbrojtjen e të drejtave të drejtorëve dhe skenaristëve të kinematografisë shqiptare dhe veprave audio-vizuale;
- Agjencia e Administrimit Kolektiv të së Drejtave të Lidhura me të Drejtën e Autorit “AKDIE” – për mbrojtjen e interpretuesve dhe artistëve;
- Agjencia e Administrimit Kolektiv të së Drejtave të Lidhura me të Drejtën e Autorit “AMI” – për të drejtat e prodhuesve të fonogramit.

DPPM dhe ZSHDA janë institucionet kryesore përgjegjëse, të angazhuar direkt me çështjet e pronësisë industriale, pronësisë intelektuale si dhe të drejtat e autorit në Shqipëri. Ato bashkëpunojnë me një sere institucionesh të tjera, të cilat mbështesin punën e tyre. Këto institucione janë listuar si me poshtë:

1.3.3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Struktura përkatëse brenda kësaj Drejtorie që adreson çështje të të drejtës së autorit është Drejtoria Kundër Krimit Financiar, e cila merret me veprat penale në sektorin ekonomik që rregullohen nga Kodi Penal. Kjo Drejtori është pjesë e Departamentit të Hetimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Fusha e veprimit dhe qëllimi i kësaj Drejtorie është veçanërisht lufta dhe parandalimi i aktiviteteve kriminale në sektorin e ekonomisë si; korrupsioni, pastrimi i parave dhe krimet në sektorin ekonomik dhe financiar dhe krimet kompjuterike.

Nënët 147, 148 dhe 149 të Kodit Penal shqiptar i kushtohen në veçanti falsifikimit dhe mashtrimit në fushën e veprave të artit dhe kulturës, botimit të veprës së dikujt tjetër me emrin tënd, riprodhimin e veprës pa autorizimin e autorëve.

Praktikisht, funksioni i Drejtorisë përballet me një situatë tepër të rënduar për sa i përket të drejtës së autorit në Shqipëri. Fatkeqësisht, tregu shqiptar është i dyndur me mallra të falsifikuara, kryesisht të importuara dhe vetëm një pjesë shume e vogël të prodhuara në Shqipëri. Legjislacioni mund të konsiderohet si një problem madhor në lidhje me trajtimin e markave dhe mallrave të falsifikuara. Në Kodin Penal aktualisht nuk ka asnjë linjë të përshtatshme veprimi që mund të zbatohet. Deri tani, policia është përpjekur të reagojë bazuar në nenin 190 “Falsifikimi i vulave, stampave dhe formularëve” dhe nenin 288.a “Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë”, por asnjë prej dispozitave të mësipërme nuk mund të përdoret në rastin e falsifikimit të markave. Arsyeja është se neni 190 zakonisht nuk zbatohet dhe neni 288.a zbatohet vetëm nëse ndodh prodhimi. Për këtë arsye nuk mund të merret asnjë masë kundër shkelësit dhe prandaj ky shkelës nuk mund të ndëshkohet apo të burgoset. Sepse në shumicën e rasteve markat/mallrat e falsifikuar nuk prodhohen në Shqipëri dhe në vend nuk gjendet asnjë fabrikë apo vend prodhimi.

Megjithatë, institucionet e përfshira kanë bërë propozime konkretë për ndryshime të Kodit Penal (nënët 147, 148, 149) dhe të Kodit të Procedurës Penale (nënët 59 dhe 284). Ndryshimet janë pjesë e kuadrit legjislativ të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2010. Ndryshimet duhet ta ndihmojnë policinë në zbatimin më efikas të të drejtave të PI-së në Shqipëri.

Nënët 147, 148 dhe 149 të Kodit Penal shqiptar i kushtohen në veçanti falsifikimit dhe mashtrimit në fushën e veprave të artit dhe kulturës, botimit të veprës së dikujt tjetër me emrin tënd, riprodhimin e veprës pa autorizimin e autorëve. Këto sjellje përbëjnë shkelje dhe në shumicën e rasteve ndiqen me procese gjyqësore. Megjithatë, raste të veçanta, veçanërisht rasti i botimit të punës së tjetrit me emrin e shkelësit, me kusht që denoncimet të jenë adresuar në polici, ndiqen nga departamentet kundër krimit ekonomik.

Një nga shkeljet, e cila përfshihet në strukturat kundër krimit financiar, është “prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë” parashikuar nga neni 288/a i Kodit Penal. Ky lloj krimi, edhe pse nuk është shumë i përshtatshëm për luftën kundër

mallrave të falsifikuara për shkak të problemeve të sipërpërmendura të interpretimit, trajtohet gjerësisht nga strukturat kundër krimit ekonomik, duke trajtuar rastet e bllokimit të mallrave të falsifikuara kryesisht në lidhje me pronësinë industriale, markat e falsifikuara etj.

1.3.4.Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Administrata Doganore shqiptare ka një detyrim ligjor që të kontrollojë të gjitha mallrat, mjetet e transportit dhe pasagjerët që kalojnë kufirin në pikat doganore që përfshijnë hapësirën tokësore, ujërat detare territoriale dhe të brendshme, hapësirën ajrore që shtrihet mbi hapësirën tokësore dhe ujërave detare territoriale dhe të brendshme dhe çdo territor tjetër nën sovranitetin e shtetit shqiptar. DPD-ja është nën mbikqyrjen e Ministrisë së Financës dhe është organizuar në tre departamente: (1) Departamenti Teknik; (2) Departamenti Administrativ; (3) Departamenti Operativ Hetimor. Në Departamentin Operativ Hetimor është ngritur Drejtoria për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale.

Aktualisht, nëpërmjet kësaj Drejtorie, autoritetet doganore kanë të drejtë të:

- reagojnë nëpërmjet kërkesës formale të zotëruesit të të drejtave;
- reagojnë edhe në bazë ex officio;
- ndërmarrin bllokimin e mallrave;
- zbatojnë masa të përkohshme në rastet kur zotëruesi i të drejtës mund të vërtetojë shkeljen e të drejtave të PI-së;
- shkatërrojë mallrat e piratuara dhe të falsifikuara;

Këto dy institucione të sipërpërmendura, për nga objekti i punës se tyre kanë lidhje të dobët me subjektin e DPPM. Në fakt, skemat funksionale e Sektorit të Luftës Kundër Krimit Ekonomik si dhe në Drejtorinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale nuk kanë strukturë integruese me proceset funksionale të DPPM apo ZSHDA.

Institucione të tjera të përfshira

1.3.5.Ministria e Drejtësisë

Aktualisht, ky institucion qëndror luan një rol indirekt në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të PI. Konkretisht, Roli i kësaj Ministrie, është që, në bashkëpunim me Ministrinë e Integritit, të garantojë përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian. Aktualisht, është duke u finalizuar Ligji i ri për të Drejtën e Autorit, proces ky ku Ministria e Drejtësisë luan rol thelbësor në finalizimin e kontekstit përmbajtësor legjislativ.

Në fushën e zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale ekzistojnë aktualisht problemet e mëposhtme, për zgjidhjen e të cilave roli i Ministrisë është thelbësor. Roli i saj është i rëndësishëm në adresimin e :

- 1) Ndryshimeve të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale – procesi ka nisur dhe pritet të përfundojë brenda vitit 2010.

- 2) Përmirësimin e punës së ngadaltë dhe e pamjaftueshme e gjykatave në përgjithësi dhe në mosmarrëveshjet për PI-në në veçanti.
- 3) Mungesa e një sistemi trajnimi për gjyqtarët/prokurorët në përgjithësi dhe në fushën e PI-së në veçanti.

1.3.6.Shkolla e Magjistraturës

Shkolla e Magjistraturës është një institucion publik i subvencionuar nga shteti, i cili gëzon pavarësi financiare, akademike dhe administrative. Ky Institucion siguron kualifikim profesional për gjyqtarët dhe prokurorët shqiptarë nëpërmjet Programit të Kualifikimit Profesional, i cili përfshin:

- Programin e Kualifikimit Fillestar për kandidatet për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Programin e Kualifikimit të Vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë;

Këto dy Programe konsistojnë në zhvillimin e programeve teorike dhe praktike, të seancave akademike, ëorkshop-eve, seminareve, tryezave të rrumbullakëta, diskutimeve dhe aktiviteteve të tjera me qëllim transmetimin e njohurive dhe informacionit bashkëkohor për përmirësimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjatë orëve të kualifikimit dhe seminareve të trajnimit, synohet dhënia e njohurive të nevojshme për zhvillimin e ligjeve të ndryshme; gjithashtu me jurisprudencën ndërkombëtare; për mënyrat e reja të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve; problemet e administrimit të çështjes; etikën profesionale; pronësinë intelektuale dhe industriale; arsyetimin dhe shkrimin ligjor.

1.3.7.Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) është institucioni përgjegjës që mbikqyr zbatimin e dispozitave të ligjit në lidhje me të drejtat e transmetimit të programeve radiofonike dhe televizive, të cilat përfshihen në mënyrë indirektë në mbrojtjen e pronësisë intelektuale. Roli i tij në mbrojtjen e këtyre të drejtave realizohet nëpërmjet rolit kontrollues që i ka caktuar ligji si dhe nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet e tjera. Në rast të shkeljeve të evidentuara, KKRT mund të vendosë sanksione që nga gjobitja, ulje të afatit të licencës apo edhe heqje të plotë të licencës së operatorit radio-televiziv.

1.4.Publiku dhe të Drejtat e Autorit

Ajo që mund të thuhet në këtë rast është mungesa e sensibilizimit të publikut në përgjithësi lidhur të drejtën e autorit dhe pronësinë intelektuale. Diçka me ndryshe është situata për sa i përket pronësisë industriale, ku për shkak të punës inspektuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Doganave si dhe Drejtorisë së Hetimit kundër Krimit Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, të paktën sektori i biznesit është i informuar për sa i përket procedurave dhe penalteteve që vendosen në rastin e shkeljeve.

Por kjo është vetëm një pjese tepër e vogël e medaljes. E verteta është se në Shqipëri, njërezit vazhdojnë të tregohen indiferentë lidhur me origjinën e mallrave që ata blejnë, vertetesinë e

markes se produktit apo edhe cilesinë e tij. Kjo vjen për shkak edhe të kushtëzimeve financiare, ku mallrat e piratuara ofrohen me një çmim shume me të lire se origjinalet.

Ndërkohë duhet theksuar mungesa thuajse e plotë e ndërgjegjësimit të publikut nëpërmjet programeve arsimore. Në asnjë nivel arsimor në Shqipëri nuk trajtohen çështjet e pronësisë intelektuale dhe të drejtat e autorit. Plagjiatura është bërë një fenomen i rendomtë në shkolla, e cila stimulohet edhe nga numri i madh i nxënësve nëpër klasa, duke e bërë praktikisht të pamundur për mesuesit dhe pedagoget verifikimin dhe bllokimin e tij.

Media, e cila duhet të ketë rolin e vetë promovues dhe ndërgjegjësues në këtë fushë të të drejtës, vazhdon të manifestojë reagime negative në dem të ndërgjegjësimit të publikut. Kjo vihet re sidomos në stacionet lokale të transmetimeve televizive të cilët vazhdojnë të shfaqin progama të piratuara. Ndërkohë, mungesa e mesazheve ndërgjegjësuese në media për të drejtën e pronësisë intelektuale është thuajse e plotë.

1.5.Përfundime të Kuadrit Ekzistues

Analiza e kuadrit ekzistues të zbatimit të të drejtave të pronësisë në Shqipëri identifikon nevojën për identifikimin e një kuadri të gjerë dhe të integruar politikash që duhen të ndërmerren nga Qeveria Shqiptare, Ministrinë e linjës si dhe institucionet përgjegjëse. E gjithë kjo duhet të bazohet në një vizion të qartë dhe afatgjatë, i cili do të përcaktojë rrugën e Shqipërisë drejt mbrojtjes dhe promovimit bashkëkohor të të drejtave të pronësisë intelektuale. Për këtë arsye, është thelbësore vlerësimi i kujdesshëm i modeleve të vendeve të tjera përendimore duke adoptuar ato politika dhe masa të nevojshme për përmirësimin e situatës së të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri.

Duke qënë se Shqipëria dhe institucionet shqiptare kanë relativisht pak eksperiencë në këtë fushë, i gjithë procesi është bazuar në krijimin e disa institucioneve që merren në mënyrë specifike me këto çështje. Ndërkohë, çështja e të drejtave të pronësisë intelektuale ka një dimension shume të gjerë, i cili duhet të adresohet në mënyrë strategjike me programe të posaçme që prekin fushën e arsimit, medias, fushatave të ndërgjegjësimit, promovimit, etj. Të gjitha këto kërkojnë politika të qarta në nivel qeverisjeje qëndrore dhe vendore, të cilat do të mundësonin koordinimin e ndërhyrjeve në kuadrin legjislativ, në strukturat administrative të institucioneve apo edhe në proceset funksionale të tyre.

Politikat e propozuara duhet të synojnë konsolidimin e një kuadri ligjor të integruar që do të mundësoje funksionimin sa me të mirë të institucioneve për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Konkretisht, procesi i papërfunduar për hartimin dhe miratimin e Ligjit të ri për të Drejtat e Autorit, krijon një situatë paqartësie lidhur me vendimmarrjen dhe procedurat që Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit zbaton aktualisht. Megjithëse ky Institucion vepron në bazë të një Ligji tjetër, nr. 9380 dt.4 Prill 2005: “Për të drejtën e autorit e të drejta të tjera të lidhura me të”, nisja e procesit për një Ligj të ri krijon në mënyrë indirekte pasivitet në zbatimin e legjislacionit aktual.

Problematike është trajtimi i falsifikimit të markave industriale në Kodin Penal. Duke qënë se neni 190 i Kodit, në pjesën me të madhe të rasteve nuk zbatohet, ndërkohë që Neni 288a zbatohet vetëm nëse ndodh prodhimi i mallrave, nuk mund të merret asnjë masë ndëshkimore

ndaj shkelësve. Në këtë kontekst është tepër thelbësore rivlerësimi i ketyre Nëneve në Kodin Penal, duke trajtuar çështjet e markave industriale që importohen.

Kapacitetet inspektuese dhe monitoruese të institucioneve që merren me çështjet e të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri janë thelbësore për të garantuar suksësin e zbatimit të politikave dhe masave që do të ndërmerren në të ardhmen. Për këtë arsye, është e nevojshme që vlerësimi i nevojave për rritjen e numrit të stafeve respektive të konceptohet si proces afatgjatë dhe gradual, duke respektuar burimet njërezore ekzistuese dhe duke e bazuar suksësin e ndërhyrjeve në kombinimin e veprimeve të institucioneve apo subjekteve të ndryshme.

Rritja e kapaciteteve profesionale të stafeve të institucioneve të angazhuara në mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Si të gjitha proceset e reja që nisin të zbatohen, është e nevojshme të shoqërohen me përmirësimin e nivelit profesional në të gjitha nivelet të stafeve përgjegjëse. Proceset e kualifikimit duhet të konceptohen në nivele afatgjata kohore dhe të shoqërojnë gradualisht skemat e riorganizimit institucional të subjekteve. Ajo që është e rëndësishme është kombinimi i proceseve kualifikuese midis institucioneve të ndryshme, duke garantuar zbatimin e suksësishëm dhe të integruar të funksioneve të ardhshme të secilit institucion në mbrojtje të të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri.

KAPITULLI II

VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

STRATEGJIA PËR ZBATIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELLEKTUALE

2.1. Vizioni i Qeverisë Shqiptare.

Në bazë të përfundimeve të analizës së mesipërme, Vizioni i Qeverisë Shqiptare, lidhur me Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (DPI) është:

Garantimi dhe zhvillimi i një sistemi bashkëkohor të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri, në funksion të konsolidimit të një sistemi social ekonomik konkurrues me të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët shqiptarë si dhe në përputhje me të gjitha kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga procesi i integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

2.2. Prioritetet Strategjike.

Prioritetet strategjike vijnë si rezultat i detyrimeve që rrjedhin nga: (1) Dokumenti i Partneritetit Europian (EPD); (2) Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA); (3) Progres Raportet e KE- së, për Shqipërinë, të viteve 2008 dhe 2009; (4) Marrëveshja TRIPS dhe Acquis të BE-së. Konkretisht, strategjia për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale synon:

- Ulja e nivelit të piraterisë, fallsifikimit dhe të informalitetit në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale, përmes:
 - Përmirësimit të mekanizmit që siguron mbrotjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, përmes përfundimit të plotësimit të kuadrit rregullator dhe legjislativ,
 - Reformës së inspektimit me qëllim uljen e shkeljeve dhe përmirësimin e zbatimit të legjislacionit në fushën e të drejtave të pronësisë industriale dhe të drejtave të autorit;
 - Përmirësimit të sistemit të menaxhimit të informacionit për të drejtat e pronësisë intelektuale.
- Mbrojtja e pronësisë intelektuale nëpërmjet, midis të tjerave, forcimit dhe konsolidimit të Drejtorisë së Patentave dhe Markave, Zyrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit, ngritjes së Inspektoriatit të Tregut për pronësinë intelektuale; forcimit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndër-institucional, veçanërisht në nivel e qëndror por edhe në nivel rajonal;
- Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit dhe transparencës, informimit dhe trajnimit për sistemin e PI-së në përgjithësi.

2.3. Objektivat Strategjike.

Strategjia e propozuar do të përqëndrohet në katër objektivat strategjike të mëposhtme:

1. Përfundimi i plotësisht të kuadrit rregullator dhe legjislativ.
2. Zhvillimi dhe forcimi i institucioneve, të përfshira në zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Këtu do të përfshihen masa në fushën e teknologjisë së informacionit, trajnimeve profesionale; kjo do të mbulojë gjithashtu zhvillimin e shërbimeve të tilla si shërbimet e ndërgjegjësimit dhe arsimimit që duhet të ofrohen nga institucionet kryesore për partnerët vendas dhe grupet e interesit;
3. Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit midis institucioneve, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel rajonal apo me gjerë, në funksion të përmirësimit të punës në mbrojtje të të drejtave të pronësisë intelektuale;
4. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut në Shqipëri lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale;

Për funksionimin e suksesshëm të sistemit të zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, arritja e secilit prej objektivave të mësipërme është thelbësore. Secili prej objektivave përfshin shumë veprime dhe aktivitete, disa prej të cilave mund të përmbushen brenda një periudhe kohore relativisht të shkurtër dhe disa mund të kërkojnë të paktën përpjekje afatmesme. Kështu, plani i veprimit i propozuar do të bëjë dallimin midis periudhës afatshkurtër (periudhë 2 vjeçare) dhe periudhës afatgjatë (3 vitet e mbetur).

KAPITULLI III

POLITIKAT

STRATEGJIA PËR ZBATIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

3.1. *Parime të përgjithshme.*

Strategjia për Pronësinë Intelektuale në Shqipëri ka për qëllim të identifikojë politikën e Qeverisë Shqiptare dhe strukturave që ajo administron për zbatimin e të drejtave mbi këto pronësi, si dhe të stimulojë zhvillimin e një procesi gradual të forcimit të gjithë sistemit në funksion të zbatimit të kësaj përgjegjësie në të ardhmen. Duke u bazuar në Objektivat Strategjike të listuar si më sipër, dokumenti në vazhdim prezanton kuadrin e nevojshëm të politikave për plotësimin e këtyre objektivave.

Në funksion të zhvillimit dhe zbatimit të këtyre politikave, në këtë kapitull rivlerësohen në vazhdim rolet, funksionet si dhe strukturat e institucioneve apo subjekteve kryesore të angazhuar në mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI) në Shqipëri. Aty ku është vlerësuar si e përshtatshme janë propozuar rekomandime që mund të çojnë në arritjen e objektivave strategjike të mësipërm.

Për përcaktimin e politikave dhe masave të propozuara, Strategjia është bazuar në:

- Rëndësinë e madhe që ka procesi në rrugën e Shqipërisë drejt konsolidimit të një shoqërie konkurruese, shumë pranë integritit në Bashkimin Europian. Për këtë arsye, propozimet orientohen në mënyrë të tillë që të krijojnë një analogji me metodologjitë dhe modelet e aplikuara jo vetëm në vendet që kanë hyre rishtazi në Komunitetin Europian por edhe me modelet e vendeve me të zhvilluara si Gjermania, Britania e Madhe, etj.
- Marrjen në konsideratë të mungesës së ndërgjegjësimit dhe përvojës afatgjatë si të publikut por edhe të institucioneve në Shqipëri lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale. Për këtë arsye, analiza Strategjike trajton në mënyrë specifike çështjen e kapaciteteve të institucioneve si element thelbësor që garanton suksesin e zbatimit të saj.
- Kombinimin e përmirësimit të kuadrit ligjor me masat për rritjen e kapaciteteve të institucioneve dhe stafeve përkatës të tyre në mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Këto masa janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të Strategjisë në të ardhmen.

3.2 *Politikat*

Për shkak të kontekstit ekzistues, përmirësimi i zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri ka për të qënë një proces kompleks dhe relativisht i gjatë. Si i tillë, ai

nuk mund të lihet si përgjegjësi vetëm e disa institucioneve. Është i nevojshëm konsolidimi i një bashkëpunimi të gjerë dhe afatgjatë midis shume autoriteteve të tjera administrative duke garantuar jo vetëm adaptimin gradual dhe të kujdesshëm të bazës ligjore të DPI por edhe identifikimin e masave dhe veprimeve të integruara me njëra tjetren.

3.2.1. Përmirësimi dhe Konsolidimi i Kuadrit Ligjor

a. Strategjia për mbrojtjen e DPI propozon finalizimin sa më të shpejtë të Ligjit të ri për të Drejtën e Autorit, duke përfshirë zbatimin e ligjit Komunitar dhe të të gjitha detyrimeve të vendosura nga marrëveshja TRIPS. Projekt ligji i ri duhet të diskutohet me të gjitha institucionet publike përgjegjëse si dhe me aktoret kryesore që ndikohen apo janë të angazhuar në çështjet e pronësisë intelektuale. Si të tilla, Strategjia propozon vlerësimin e projekt ligjit të ri nga subjektet si me poshtë:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM);
2. Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA);
3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH);
4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD);
5. Ministria e Arsimit, Ministria e Drejtësisë;
6. Shkolla e Magjistraturës;
7. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, Prokuroria;
8. Agjencitë e Administrimit Kolektiv;
9. Inspektorati për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.,
10. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
11. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
12. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
13. Subjektë të tjere;

Në mënyrë të ngjashme, DPPM-ja dhe ZSHDA-ja do të jenë përgjegjëse për përfshirjen edhe të institucioneve apo agjencive të tjera gjatë zbatimit të strategjisë, si: Ministria e Bujqësisë, Agjencitë Rajonale të Turizmit, shoqatat e botuesve, siç përmendet më poshtë.

Ndërkohë, në funksion të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet që Republika e Shqipërisë ka lidhur me institucionet ndërkombëtare për pronësinë intelektuale, dhe në mënyrë specifike direktivat e KE, Ligji i ri duhet të transpozohet:

- Direktivën 2004/48/KE “Për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale”;
- Direktivën 2001/29/KE “Për harmonizimin e disa aspekteve në shoqërinë e informacionit”;
- Direktivën 2001/84/KE “Për të drejtën e rishitjes në dobi të autorit të një vepre arti origjinale”;
- Direktivën 2006/115/KE – ndryshime të Direktivës 92/100/KEE;
- Direktivën 2006/116/KE – ndryshime të Direktivës 93/98/KEE.

Ligji i ri pritet të përmirësojë fushat e mëposhtme:

- Sigurimin e mbrojtjes më të mirë të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të.
- Forcimin dhe shtimin e kontrollit, monitorimit dhe mekanizmave (mjetet) shtetërorë ndëshkues, si dhe krijimin e “filtrave” për masa më efektive për importuesin,

eksportuesin, prodhuesin, përdoruesin ose shfrytëzuesin e subjekteve të veprave artistike, kulturore dhe shkencore.

- Caktimin e detyrave dhe procedurave administrative për çdo institucion shtetëror. Si dhe rregullimin e bashkëpunimit midis njëri-tjetrit në mënyrë që zinxhiri institucional të jetë funksional dhe efikas.
- Mbulimin më të gjerë dhe specifikimin e rasteve që përbëjnë kundërvajtje administrative ose penale, shkelje ose vepër penale. Si rezultat i këtyre specifikimeve të reja parashikohet rritja e vlerave dhe masave të sanksioneve ndëshkimore.
- Ndryshimet e rëndësishme në lidhje me procedurat administrative përpara ZSHDA-së (dy shkallë, vendimi përfundimtar i Drejtorit të Përgjithshëm, i cili mund të apelohe në Gjykatën e Shkalles së II në Tiranë).
- Ligji i ri për të drejtën e autorit duhet të qartësojë gjithashtu të drejtat dhe detyrimet e agjencive të administrimit kolektiv kundrejt ZSHDA-së (shikoni më poshtë, Agjencitë e administrimit kolektiv)

b) Ndryshimet e Kodit penal dhe ligjeve dhe vendimeve të tjera

Në bashkëpunim me organet qeveritare përgjegjëse (Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme), duhet të propozohen projekt ndryshimet e Kodit Penal në mënyrë që ai të mbulojë me efikasitet të gjitha krimet në fushën e pronësisë intelektuale (të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të) dhe të sanksionojë gjobat përkatëse në rastin e shkeljeve, duke përfshirë gjobat e mëdha për krimin e organizuar.

Në bashkëpunim me organet e tjera qeveritare përgjegjëse për fushat përkatëse, ZSHDA-ja duhet të propozojë më tej ndryshimet e nevojshme në ligjet dhe vendimet e mëposhtme:

- Projekt ligji “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 8410 datë 30 shtator 1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”*”, të ndryshuar
- Projekt ligji “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 8096 datë 21 mars 1996 “Për kinematografinë”*”, të ndryshuar
- Projekt vendimi “*Për disa ndryshime në VKM nr. 547 datë 1 maj 2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 205 datë 13 prill 1999 “Për dispozitat zbatuese të kodit doganor”*”, të ndryshuar.

3.2.2. Forcimi dhe Zhvillimi i Institucioneve

DPPM dhe ZSHDA do të konsolidohen si institucionet kryesore që do të trajtojnë sistemet e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale dhe pronësisë intelektuale. Si të tilla forcimi institucional i tyre në të ardhmen është thelbësor. Në kontekstin e kësaj politike, Strategjia synon:

- Rivlerësimin e strukturave të brendshme të institucioneve kryesore që merren me të drejtat e pronësisë intelektuale në Shqipëri. Qëllimi i këtyre proceseve nuk është ndryshimi ad-hoc i organigramave përkatëse, por vlerësimi i kujdesshëm i roleve dhe përgjegjësisë të çdo departamenti apo drejtorie në lidhje me DPI dhe ajo që është me e rëndësishme koordinimi i këtyre funksioneve brenda institucioneve si dhe me

institucionet e jashtme mbështetese si Drejtoria e Përgjithshme e Policise, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, etj.

- Rritja e kapaciteteve të stafëve të këtyre institucioneve lidhur me kontekstin e përgjithshëm të pronësisë intelektuale, zhvillimin e këtij konteksti në Shqipëri si dhe me rolet dhe përgjegjësitë konkrete që kanë brenda institucioneve. Për këtë arsye është e nevojshme organizimi në fazën e parë të cikleve intensive të trainimit për stafet e të dy institucioneve.
- Përmirësimi i bazës së informacionit – regjistri i patentave dhe markave si dhe regjistri për të drejtat e autorit.
- Përmirësimi i logjistikës së të dy institucioneve në funksion të përmirësimit të shkëmbimit të shpejtë dhe eficient të informacionit jo vetëm brenda strukturave të tyre por edhe me institucionet e tjera mbështetese;

3.2.2.1. DPPM

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave e Markave do të konsolidohet si Institucioni i vetëm që ka për objekt mbrojtjen e Pronësisë Industriale e cila është dhe objekti kryesor për forcimin e se ciles janë të interesuar EC.

Zyra Europiane e Patentave (Pronësia Industriale e EU), duhet të këtë rolin kryesor dhe implementues të kësaj strategjie.

Politikat kryesore që duhet të ndjekë DPMP, janë si me poshtë:

1. **Përfundimi i kuadrit legjislativ dhe rregullator.** (1) Ratifikimi i Marrëveshjes së Londrës (1 projekt ligj të dërgohet në parlament);
2. **Forcimi institucional, nëpërmjet:** (1) Studim i standardeve, studim i fizibilitetit, projekt; Përshkrimet e reja të punës, fushata e rekrutimit. (2) Trajnimi i personelit të DPPM-së. (Kurrikula dhe dokumentacioni i trajnimit, rritja e njohurisë); (3) Numri i personelit të trajnuar në mënyrë efektive, përqindja e arritjes së kurrikulës; (4) Vlerësimi i IT-së (Mjedisi i zgjeruar i IT-së, tërmat e referencës; Shtimi i shërbimeve në linjë (*on line*); Realizimi i efikasitetit të ri, përdorimi i sistemit të ri nga publiku; hartimi i shërbimeve elektronike; vendimet në bazën e të dhënave; kuadri ligjor për publikimin; regjistrimi në linjë (*on line*))

Procesi i integritimit në Bashkimin Europian, rritja dhe zhvillimi ekonomik si dhe përmirësimi i nivelit arsimor në shoqërinë shqiptare do të kontribuojnë në një përdorim më intensiv të sistemit të pronësisë industriale dhe rrjedhimisht do të rrisin ngarkesën e punës së DPPM-së. Në mënyrë të veçantë ky institucion do të fokusohet në rritjen e kapaciteteve në trajtimin e proceseve gjyqësore si dhe në konsolidimin e strukturave bashkëkohore të administrimit dhe shpërndarjes së informacionit.

Kjo e fundit ka lidhje me kompetencat që ka DPPM për krijimin e një rrjeti Qëndrash për Informacionin Teknik dhe Shkencor që duhet të bashkëveprojë me një rrjet kombëtar qëndrash të informacionit të patentave (PATLIB). Forcimi i këtyre strukturave do të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme aksesin e publikut dhe njohjen e tij me të çështjet e pronësisë industriale. Njëkohësisht, këto struktura do të ofrojnë shërbime në fushën e pronësisë industriale për sferën akademike dhe komunitetin lokal për kërkime dhe zhvillim:

akses në dokumentacionin botëror të patentave, shërbime para regjistrimit të tilla si kërkimet moderne, diagnostikim paraprak i PI-së, mbështetje në transferimin e teknologjisë.

Këto detyra kërkojnë mbështetje nga departamentet e patentave, markave tregtare dhe IT-së/dokumentacionit.

Sektori i Patentave:

Personeli për sektorin e patentave duhet të përfshijë profesionistë të kualifikuar (ekzaminues) me arsimin përkatës në të drejtat e pronësisë industriale. Të gjithë ekzaminuesit duhet të zotërojnë arsim të specializuar dhe përvojë në fushën e ligjit për patentat, ekzaminimit të aplikimeve për patenta dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për patentat, përkatësisht brenda proceseve të revokimit/anulimit. Ky seksion duhet të punësojë ekspertë me arsim të lartë (diplomë universitare) në fushën e inxhinierisë mekanike, inxhinierisë elektrike (fizikë), farmakologjisë dhe bioteknologjisë. Megjithatë, duke pasur parasysh aktivitetin aktual kombëtar në fushën e patentave, si dhe mungesën e përgjithshme aktuale të personelit, ky objektivi global duhet të përmbushet vetëm për një periudhë afatgjatë, por rekrutimi duhet të fillojë në një periudhë afatshkurtër.

Përveç ekspertëve përkatës në fushat e inxhinierise dhe teknologjive, është mjaft e rëndësishme krijimi i skemave të bashkëpunimit me universitetet apo me institucionet e tjera shkencore. Në këtë mënyrë do të shmangej fryrja e panevojshme e këtij departamenti me ekspertë të çdo fushe të cilët do të benin ekzaminimin e kërkesave për patenta dhe regjistrimin e tyre.

Sektori i Markave Tregtare, Dizenjove dhe Emertimeve të Origjinës; i nënshtrohet në mënyrë më të drejtpërdrejtë rritjes së ngarkesës së punës, sepse shenjat dalluese zbatohen më me lehtësi sësa patentat, veçanërisht në ekonominë në tranzicion. Ngarkesa kryesore e punës për regjistrimin/ekzaminimin në DPPM do të mbëtet në këtë sektor. Ky sektor duhet të përfshihet edhe në aktivitetet promovuese dhe sensibilizuese.

Në këtë sektor duhet të punësohen specialistë të aftë të menaxhojnë markat tregtare (6000 regjistrime në vitin 2008). Duhet të merret parasysh fakti që aktualisht ka rreth 90 000 aplikime për marka komunitare (MK) në vit dhe të drejta që rrjedhin nga këto. MK do të shtrihen në Shqipëri pas aderimit të saj në BE. Përveç ngarkesës së punës që lidhet me markat tregtare, personeli duhet të jetë në gjendje të trajtojë dizenjot industriale, emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë.

Sherbimet Ligjore; duhet të trajtojnë jo vetëm ngarkesën e punës në rritje për sa i përket aktivitetëve ndërkombëtare dhe zhvillimit të traktatëve ndërkombëtare, por edhe përfaqësimin e ardhshëm të interesave të Shqipërisë në institucionet kryesore të Bashkimit Europian (në KE në fushën e treguesve të origjinës dhe treguesve gjeografikë dhe në Zyrën e Varieteteve të KE-së në fushën e të drejtave për varietetet e reja të bimëve, në ZEP në fushën e patentave, në OHIM në fushën e shenjave dalluese) ose në mbarë botën (WIPO në të gjitha fushat e PI-së) dhe sërish në Komisionin Europian për sa i përket integritimit europian.

Parashikohet një rritje e ngarkesës së punës nëpërmjet shtimit të rasteve që duhet të zgjidhen nga departamenti i apelit dhe rrjedhimisht, me përfaqësimin e DPPM-së në çështjet gjyqësore. Ambienti i ri do të kërkojë një mbështetje ligjore më të gjerë të të gjitha proceseve që lidhen me ekzaminimin e institutëve ligjore individuale dhe me nevojën për të specifikuar

më tej të gjitha llojet e rregulloreve të brendshme ligjore. Strategjia propozon që vetë DPPM të rivlerësojë numrin e personelit të këtij departamenti në funksion të përmirësimit të efijences se tij.

Departamenti i IT-se: krijimi i Qëndrave PATLIB në të gjitha rajonet e vendit si dhe mbajtja dhe përditësimi i regjistrit të patentave dhe markave, lehtësisht të aksesueshme nga të gjitha qendrat, do të kerkoje një angazhim dhe rivlerësim të kujdesshëm nga ana e Drejtorisë. E rëndësishme gjithashtu do të jetë krijimi i aksesit të plotë të informacionit për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Universitetet, etj.

Gjithashtu, në misionin e saj për të shtuar ndërgjegjësimin rreth PI-së dhe për të zhvilluar një sistem të pronësisë industriale, DPPM-ja përballlet me sfidën e zhvillimit të shërbimeve të reja të IT-së, të cilat janë paraqitur më hollësisht më poshtë (shikoni Teknologjia e informacionit). Përveç kësaj, ky seksion është përgjegjës për punën e zakonshme të zyrës: printimi i patentave dhe çertifikatave, kryerja e ndryshimeve dhe amendamenteve në dokumente të ndryshme, duke përfshirë ndryshimin e pronarëve dhe përfaqësuesve të tyre, rinovimet, skadimi i vlefshmërisë, dërgimi i Buletinit Zyrtar dhe aktivitete të ngjashme.

Teknologjia e informacionit: Përmirësimi dhe zgjerimi i mëtejshëm i fushës së mbështetjes nëpërmjet teknologjisë së informacionit është një masë thelbësore e marrë me qëllim lehtësimin e situatës në aspektë të ndryshme. Së pari, garanton përsheptim të mëtejshëm të të gjitha aktiviteteve bazë të DPPM-së, veçanërisht përpunim të aplikimeve, monitorim të saktësisë së të dhënave dhe në përgjithësi rrit produktivitetin e punës.

Gjithashtu, publiku duhet të ketë akses kompjuterik në të gjitha të dhënat kyç në lidhje me të drejtat e pronësisë industriale në fuqi në Shqipëri. Për këtë qëllim, duhet të ngrihen servera botimi për të gjitha të drejtat e pronësisë industriale duke përfshirë një motor kërkimi të disponueshëm për publikun.

Kjo jo vetëm që do të krijontë mjedisin më të mirë ligjor për parandalimin e shkeljeve të të drejtave të pronësisë industriale por do të garantontë gjithashtu një proces optimal të zbatimit të këtyre të drejtave. Të gjitha institucionet kyç që merren me zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale duhet të kenë mundësinë që të verifikojnë në çdo kohë, me anë të mjeteve elektronike, se cilat të drejta janë në fuqi në Shqipëri, cili është zotëruesi dhe cila është fusha e tyre e veprimit. Prandaj, industria, qarqet akademike, policia, inspektimi i tregtisë, administrata e doganave, gjykatat, administrata e tatimeve, avokatet e patentave, avokatet dhe organet e tjera, do të jenë në gjendje të trajtojnë çdo shkelje të padëshirueshme të të drejtave të pronësisë industriale menjëherë dhe pa asnjë kufizim. Për këtë qëllim, duhet të krijohet një regjistër elektronik që mund të aksesohet lehtësisht, i cili përmban të dhënat ligjore të të gjitha të drejtave të pronësisë industriale.

Trajnimi i personelit të DPPM-së. Për të arritur synimet e sipërpërmendura, i gjithë stafi i DPPM duhet t'i nënshtrohen programeve të posaçme të trajnimit. Në trajnime duhet të përfshihet secili seksion i DPPM-së. ZEP-i, WIPO dhe/ose Zyrat e Europes Perëndimore mund të përfshihen në masat e nevojshme për trajnimin. Trajnimi i personelit të DPPM-së ka prioritet të lartë. Fillimi sa më i shpejtë i trajnimit është një objektiv i menjëhershëm i strategjisë. Plani i përgjithshëm i trajnimit që i përgjigjet këtij programi paraprak mund të zbatohet brenda 2 vjetësh.

Përfshirja e DPPM-së në arsimin dhe trajnimin e grupeve kombëtare të interesit që nuk ndodhen brenda në DPPM: Si pjesë e misionit të saj, DPPM-ja duhet të luajë një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin për sistemin e pronësisë industriale. Duhet të zhvillohen dy aspektet e mëposhtme:

1. Nisja e projektit “Qëndrat e informacionit shkencor dhe teknik”. Sipas këtij projekti, DPPM-ja duhet të propozojë një koncept gjithëpërfshirës për krijimin e këtij rrjeti të qëndrave të informacioni me qëllim mbështetjen e transferimit të teknologjisë dhe risive në Shqipëri. Metodologjia duhet të vlerësojë eksperiencën e PATLIB-it në shtetet anëtare në ZEP. DPPM-ja duhet ta krijojë dhe t'i japë jetë këtij rrjeti bazuar në bibliotekat ekzistuese, me objektivin e përgjithshëm të ndërgjegjësimit rreth pronësisë industriale dhe në mënyrë më të përgjithshme rreth pronësisë intelektuale: dokumentacioni (literatura botërore në fushën e patentave, aksesit elektronik në burimet teknike dhe shkencore, aksesit në bazat kombëtare të të dhënave të PI-së, informacioni i përgjithshëm rreth sistemit të PI-së në Shqipëri dhe në Europë. Që në fillim, Qendra e parë dhe kryesore duhet të ngrihet në Tiranë, ose si pjesë e ambientëve të DPPM-së ose brenda Universitetit (nëse nuk ka vende të përshtatshme brenda DPPM-së). Kjo gjë duhet të bëhet brenda dy vitëve të ardhshme, d.m.th deri në dhjetor 2012. Më pas, duhet të ndërtohet të paktën një Qendër tjetër mbështetese në një qytet tjetër të rëndësishëm, për shëmbull në Shkodër. Këto qendra që ofrojnë dokumentacion elektronik dhe një qendër virtuale e ndodhur në faqen e internetit të DPPM-së do të krijohen paralelisht.

2. rritja e kapaciteteve dhe kualifikimi i personelit të institucioneve të angazhuara në mbrojtje të pronësisë industriale (pronësisë intelektuale në bashkëpunim me Zyrën Shqiptare për të Drejtën e Autorit ZSHDA). Personeli i autoriteteve dhe institucioneve të përfshira në zbatimin e DPI-ve duhet t'i nënshtrohet një trajnimi të hollësishëm dhe të përshtatshëm për pronësinë intelektuale. DPPM-ja dhe ZSHDA-ja janë institucionet më mirë-informuara në Shqipëri rreth DPI-ve dhe prandaj ato duhet të jetë nxitëset e këtij programi arsimor. Gjithashtu, ky program arsimor duhet të ofrohet në mënyrë të përhershme, me qëllim që të merret parasysh lëvizja e konsiderueshme e personelit në administratën publike. Prandaj është e rëndësishme të organizohen dhe të përsëriten aktivitetet e trajnimit në këtë fushë edhe me qëllim stabilizimin e njohurive në fushën e PI-së brenda administratës publike.

Target grupi i parë dhe më i rëndësishëm (periudhë afatshkurtër) i këtij programi trajnimi bazë duhet të jenë zyrtarët e shtetit (domethënë punonjësit e doganave, punonjësit e policisë që punojnë në fushën e shkeljes së të drejtave të PI-së, gjyqtarët, punonjësit e Inspektoratit të Tregtisë dhe Tregut etj.). Duhet të përfshihet edhe personeli i institucioneve të tjera të përmendura në strategji si pjesëmarrëse në përpjekjen për zbatimin e të drejtave (periudhë afatgjatë).

Aktivitete të tjera të DPPM-së

DPPM-ja ka detyrat e mëposhtme shtesë që lidhen direkt me rolin e saj qëndror në fushën e PI-së në Shqipëri:

1. DPPM-ja duhet të jetë organi këshillimor i qeverisë për koordinimin e politikës për pronësinë industriale. Si i tillë, DPPM-ja duhet të jetë udhëheqës në negociatat e traktatëve të reja ndërkombëtare në fushën e të drejtave të pronësisë industriale dhe në negociatat që lidhen me PI-në në Bashkimin Europian. DPPM-ja duhet gjithashtu të koordinojë bashkëveprimin e përgjithshëm ndërinstitucional në Shqipëri në këtë fushë, për shëmbull me Ministrinë e Bujqësisë për sa i përket prodhuesve të mallrave që mund t'i nënshtrohen mbrojtjes nëpërmjet treguesve gjeografikë.
2. DPPM-ja duhet të përfaqësojë vendin në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare të mëposhtme: ZEP, OHIM, WIPO dhe ËTO.
3. DPPM-ja duhet të përfshihet në mënyrë sistematike në çdo iniciativë që synon ndërgjegjësimin e publikut rreth PI-së në Shqipëri.

3.2.2.2. ZSHDA

Strategjia identifikon se prioritet kryesorë të ZSHDA në lidhje me punën e saj për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale do të jenë:

1. Konsolidimi i kuadrit legjislativ dhe rregullator

- Ligji i ri për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me të
- Hartimi dhe miratimi i Ligjit të ri “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të” si dhe akteve të tjera nënligjore për zbatimin e tij;
- Amendimet e Kodit penal të RSH
- Amendimet e Kodit të Procedurave Penale të RSh
- Amendimi i Ligjit për Radion dhe Televizionin Publik Shqiptar
- Amendimi i VKM “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”
- Hartimi dhe Miratimi i Ligjit për Krijimin e Inspektoriatit të Tregut për IP

Ligji i ri për të drejtën e autorit

Së bashku me ekspertet e Komisionit Europian, duhet të përfundohet ligji i ri për të Drejtën e Autorit, duke përfshirë zbatimin e ligjit Komunitar dhe të të gjitha detyrimeve të vendosura nga marrëveshja TRIPS. Projekt ligji i ri për të drejtën e autorit duhet të diskutohet me të gjitha organet qeveritare përgjegjëse dhe me publikun dhe të miratohet sa më shpejt të jetë e mundur. Ligji i ri duhet të transpozojë Direktivat ekzistuese të KE-së, përkatësisht:

- Direktivën 2004/48/KE “Për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale”;
- Direktivën 2001/29/KE “Për harmonizimin e disa aspekteve në shoqërinë e informacionit”;
- Direktivën 2001/84/KE “Për të drejtën e rishitjes në dobi të autorit të një vepre arti origjinale”;
- Direktivën 2006/115/KE – ndryshime të Direktivës 92/100/KEE;
- Direktivën 2006/116/KE – ndryshime të Direktivës 93/98/KEE.

Ligji i ri pritet të përmirësojë fushat e mëposhtme:

- Sigurimin e mbrojtjes më të mirë të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të.

- Forcimin dhe shtimin e kontrollit, monitorimit dhe mekanizmave (mjetet) shtetërorë ndëshkues, si dhe krijimin e “filtrave” për masa më efikase për importuesin, eksportuesin, prodhuesin, përdoruesin ose shfrytëzuesin e subjekteve të veprave artistike, kulturore dhe shkencore.
- Caktimin e detyrave dhe procedurave administrative për çdo institucion shtetëror. Si dhe rregullimin e bashkëpunimit midis njëri-tjetrit në mënyrë që zinxhiri institucional të jetë funksional dhe efikas.
- Mbulimin më të gjerë dhe specifikimin e rasteve që përbëjnë kundërvajtje administrative ose penale, shkelje ose vepër penale. Si rezultat i këtyre specifikimeve të reja parashikohet rritja e vlerave dhe masave të sanksioneve ndëshkimore.
- Ndryshimet e rëndësishme në lidhje me procedurat administrative përpara ZSHDA-së (dy shkallë, vendimi përfundimtar i Drejtorit të Përgjithshëm, i cili mund të apelohej në Gjykatën e Shkalles së II në Tiranë).
- Ligji i ri për të drejtën e autorit duhet të qartësojë gjithashtu të drejtat dhe detyrimet e agjencive të administrimit kolektiv kundrejt ZSHDA-së (shikoni më poshtë, Agjencitë e administrimit kolektiv)

Ndryshimet e Kodit penal dhe ligjeve dhe vendimeve të tjera

Në bashkëpunim me organet qeveritare përgjegjëse (Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme), duhet të propozohen projekt ndryshimet e Kodit Penal në mënyrë që ai të mbulojë me efikasitet të gjitha krimet në fushën e pronësisë intelektuale (të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të) dhe të sanksionojë gjobat përkatëse në rastin e shkeljeve, duke përfshirë gjobat e mëdha për krimin e organizuar.

Në bashkëpunim me organet e tjera qeveritare përgjegjëse për fushat përkatëse, ZSHDA-ja duhet të propozojë më tej ndryshimet e nevojshme në ligjet dhe vendimet e mëposhtme:

- Projekt ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8410 datë 30 shtator 1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar
- Projekt ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8096 datë 21 mars 1996 “Për kinematografinë”, të ndryshuar
- Projekt vendimi “ Për disa ndryshime në VKM nr. 547 datë 1 maj 2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 205 datë 13 prill 1999 “Për dispozitat zbatuese të kodit doganor”, të ndryshuar

Forcimi institucional

Qeveria i ka dhënë zyrtarisht ZSHDA-se mandatin për të koordinuar axhendën kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Për rritjen e efektivitetit në punën e Zyrës, Strategjia propozon:

- Përmirësimin e burimeve njërezore për periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë duke përfshirë rekrutimin dhe trajnimin e stafit të ZSHDA;
- Konsolidimin e rrjetit të qendrave rajonale;
- Zhvillimin e kapaciteteve për shërbimet e ndërmjetësimit në ZSHDA;

2. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndër-institucional

- Trajnimi i autoriteteve të zbatimit të ligjit për PI-në;
- Bashkëpunim me DPPM-në për programin e ndërgjegjësimit për autoritetet e zbatimit të ligjit;

- Krijimi i një mekanizmi të vazhdueshëm për forcimin e bashkëpunimit me agjencitë e administrimit kolektiv;
- Ngritja e grupit të punës për shkeljet në internet me KEPI-in, AKSHI-in dhe KKRT-në;
- ZSHDA-ja ofron mbështetje për AKEPI-in, AKSHI-n dhe KKRT-në për monitorimin e fushave të tyre të tregut;

3. Ndërgjegjësimi për DPI-të

- Trajnimi i autoriteteve të zbatimit të ligjit për PI-në;
- Përgatitja dhe zbatimi i fushatave të ndërgjegjësimit të publikut për çështjet e pronësisë intelektuale;

Arbitrazhi dhe ndërmjetësimi: Rekomandohet që kompetencat e ZSHDA-së në lidhje me ndërmjetësimin dhe arbitrimin e mosmarrëveshjeve midis autorëve dhe agjencive të administrimit kolektiv si dhe midis agjencive të administrimit kolektiv dhe përdoruesve të veprave të artit, të përforcohen me qëllim që ZSHDA-ja të mund të japë vendime administrative përfundimtare dhe të zbatueshme në këtë fushë.

Thelbësore në këtë rast është rritja e autoritetit dhe kapaciteteve të Zyrës si qendër inspektimi për shkeljet ndaj të drejtave të autorit. Është e rëndësishme që procesi i inspektimit të tregut të shfrytëzojë në mënyrë sa më efikase Memorandumin e Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në mënyrë që të mos zhvillohen sporadikisht apo në formën e Task Forces, por të krijojnë një skemë bashkëpunimi të vazhdueshme, duke garantuar në këtë mënyrë një monitorim të plotë dhe në çdo moment.

Fuqizimi i rolit të Zyrës si qendër e ndërmjetësimit administrativ dhe arbitrazhit të mosmarrëveshjeve për të drejtën e autorit do të kerkojë në mënyrë të pashmangshme rritjen e kapaciteteve të stafit.

Qëndrat rajonale: ZSHDA-ja duhet të vazhdojë ngritjen e “Qëndrave Rajonale” të quajtura edhe “Zyra Rajonale për të Drejtën e Autorit”. Funkzioni i tyre kryesor do të jetë inspektimi i qarqeve rajonale. Ato do të përfshihen gjithashtu në informimin e publikut rreth çështjeve të së drejtës së autorit, në mbulimin e punës së agjencive të administrimit kolektiv, në funksionimin si pritës lokalë të ankimeve dhe kërkesave për arbitrazh etj.

Këto Qendra Rajonale mund të zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me DPPM-në dhe Qëndrat e saj për Informacion Teknik dhe Shkencor: Rekomandohet që të dy “Qëndrat” të kenë të paktën ambient dhe sfond administrativ të përbashkët. Në një situatë ideale të dy “Qëndrat” janë në fakt një Qendër, stafi i të cilës mund të sigurojë informacion rreth të drejtave për pronësinë industriale dhe regjistrimit dhe zbatimit të tyre, si dhe informacion rreth të drejtës së autorit. Kostoja e zhvillimit të Qendrës do të reduktohet. Gjithsej janë planifikuar që të ngrihen 12 Qendra në të gjitha qarqet administrative në Shqipëri. Afati kohor 4 vjet.

Zhvillimi i shërbimeve të ndërmjetësimit dhe arbitrazhit: ZSHDA-ja duhet t’i kushtojë vëmendje përmirësimit të ofertës në fushën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura, duhet të konsiderojë krijimin e shërbimeve të ndërmjetësimit dhe sistemit të arbitrazhit duke kërkuar uljen e numrit të mosmarrëveshjeve midis administruesve kolektivë të së drejtave dhe përdoruesve të veprave në fushën e tarifave,

taksave, pagesave dhe formaliteteve duke përfshirë marrëveshjet e zakonshme, marrëveshjet e licencimit. Afati kohor: 1 vit;

Teknologjia e informacionit: Ka nevojë urgjente për zhvillimin e bazave qëndrore të të dhënave për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, të aksesueshme nga publiku. Për shkak të faktit që në Shqipëri ekziston një sistem për regjistrimin e të drejtës së autorit, të gjithë përdoruesit duhet të jenë në gjendje të verifikojnë nëse vepra e tyre e artit që ata synojnë të përdorin është e mbrojtur nga e drejta e autorit dhe nëse është kështu, deri në çfarë shkalle është e mbrojtur dhe kush është zotëruesi i të drejtës. Kjo bazë të dhënash duhet të përmbajë edhe vendimet përfundimtare të lëshuara nga ZSHDA-ja dhe nga gjykatat në proceset kundër ZSHDA-së. Së bashku me nisjen e punës për bazën e re të të dhënave, duhet të azhurnohet dhe të përfundohet pajisja e ZSHDA-së me kompjutera. Inspektorët që punojnë në treg duhet të jenë në gjendje të kontrollojnë menjëherë statusin e regjistrimit të së drejtës së autorit, statusin e regjistrimit të tatimeve të shkelësit etj. Kjo gjë përfshin të paktën tre kompjutera portativë për ta. Numri i kompjuterave të rinj dhe softuerëve përkatës varet nga numri i punonjësve të ZSHDA-së: Aktualisht llogarisim 12 kompjutera të rinj. Nëse ngrihen Qendrat Rajonale, duhet të parashikohet të paktën një kompjuter për secilën Qendër.

Ndërgjegjësimi publik dhe arsimimi rreth të drejtës së autorit: Ashtu si DPPM-ja për pronësinë industriale, ZSHDA-ja luan një rol qëndror në arsimimin dhe ndërgjegjësimin rreth të drejtës së autorit në Shqipëri. Audiencia e ZSHDA-së përfshin punonjësit e organeve të zbatimit të ligjit, agjencitë e administrimit kolektiv të të drejtës së autorit, në mënyrë që të sigurojë një bashkëpunim më të qetë si dhe publikun në përgjithësi.

Aktivitete të tjera të ZSHDA-së

1. ZSHDA-ja duhet të jetë organi këshillimor i qeverisë për koordinimin e politikës për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të. Si i tillë, ZSHDA-ja duhet të jetë udhëheqës në negociatat e traktatëve të reja ndërkombëtare në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të dhe duhet të bashkëpunojë me DPPM-në në negociatat me Bashkimin Europian në lidhje me PI-në. ZSHDA-ja gjithashtu duhet të koordinojë bashkëpunimin e përgjithshëm ndërinstytucional në Shqipëri në këtë fushë, për shëmbull me agjencitë rajonale përgjegjëse për turizmin, me shtëpitë botuese etj.
2. ZSHDA-ja, pas këshillimit të posaçëm me autoritetet qeveritare përkatëse dhe me publikun, duhet të propozojë ligje në fushën e të drejtës së autorit në përputhje me angazhimet e reja ndërkombëtare.
3. ZSHDA-ja duhet të përfaqësojë vendin në organizatat ndërkombëtare si WIPO, WTO, UNESCO, dhe në grupimet ndërkombëtare rajonale.
4. ZSHDA-ja duhet t'i kushtojë vëmendje e veçantë mbrojtjes së bazave të të dhënave dhe programeve kompjuterike dhe marrëdhënies midis mbrojtjes së këtyre lëndëve nga perspektiva e të drejtës së autorit dhe mjeteve të tjera të mbrojtjes së këtyre lëndëve të veçanta.

3.2.2.3. Agjencitë e Administrimit Kolektiv

Lidhur me Agjencitë konstatohen mangësitë e mëposhtme:

- Mungesa e informacionit nga agjencitë për identifikimin e veprave artistike që përdorin operatorët.

- Mungesa e transparencës së agjencive për shumën e parave që mbledhin dhe që mendohet se duhet t’ua shpërndajnë si pagesë autorëve.
- Agjencitë lëshojnë një autorizim të përgjithshëm për repërtorin që mbrojnë pa specifikuar dhe pa u dhënë shpjegime përdoruesve se për cilët autorë u kanë paguar agjencive.

Rekomandimet dhe veprimet e propozuara për ADK-të.

- Ligji i ri për të drejtën e autorit duhet të përcaktojë qartë të drejtat dhe detyrimet e agjencive për sa i përket marrëdhënieve të tyre me ZSHDA-në:
- **a) Përcaktimi i rolit të agjencive:** Roli i agjencive në procesin e zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale është i kufizuar. Ato duhet të veprojnë si subjektë monitoruese me kompetencë për të kontrolluar nëse përdorimi i veprës së artit ushtrohet në përputhje me licencën e dhënë ose nëse përdoruesi e ka paguar realisht shumën e kërkuar. Agjencitë mund ta mbështesin ZSHDA-në në aktivitetet e kontrollit, duke bashkëpunuar në mënyrë efikase me ZSHDA-në: agjencitë duhet të mbledhin informacion dhe prova për shkeljen e të drejtës së autorit dhe t’ia kalojnë këto ZSHDA-së, e cila do të nisë procesin administrativ.
- **b) Përcaktimi i rolit mbikqyrës të ZSHDA-së:** ZSHDA-ja duhet të jetë në gjendje të kontrollojë të gjitha aktivitetet e agjencive në të gjitha fushat – tarifatat, pagesat, vjeljen. Agjencitë duhet të hartojnë raportë vjetore të cilat i dorëzohen ZSHDA-së. Nëse këto raportë përmbajnë mospërputhje të cilat nuk shpjegohen brenda një kohë të caktuar, Ministria ka të drejtë të revokojë licencën e agjencisë. Agjencitë janë të detyruara nga vendimet e ZSHDA-së në proceset e arbitrazhit midis tyre ose midis agjencive dhe zotëruesve të të drejtave, d.m.th. nga detyrimi për arbitrazh dhe natyra përfundimtare e vendimit në lidhje me agjencitë.

Ndryshimet e propozuara duhet të kryhen brenda kontekstit të veprave sipas ligjit të ri për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të dhe brenda të njëjtit kuadër, shikoni më sipër. Prandaj nuk propozohet asnjë plan veprimi i ri. Gjithashtu, Agjencitë duhet të luajnë një rol aktiv në promovimin e të drejtave të PI-së në përgjithësi dhe në fushatën kundër piraterisë që propozohet nën titullin ZSHDA.

3.2.2.4. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Drejtoria Kundër Krimit Financiar në Drejtorinë e Përgjithme të Policisë së Shtetit do të vazhdojë të jetë një hallke e rëndësishme në zbatimin e ligjit në fushën e pronësisë intelektuale dhe industriale. Përmirësimi i kuadrit ligjor (Kodi Penal) do të mundësonte një kryerje më të mirë të detyrave të kësaj Drejtorie në fushën e identifikimit dhe parandalimit të veprimeve të jashtëligjshme kundrejt pronësisë industriale dhe intelektuale.

Shkeljet e të drejtave të pronësisë intelektuale kanë një dimension ndërkombëtar domethënës, veçanërisht në vendet që kanë investuar me një bazë të gjerë prodhimi dhe industriale, kështu që një pjesë e mirë e mallrave në tregun e brendshëm vjen nga importi. Kjo kërkon bashkëpunimin e duhur ndërkombëtar në luftën kundër fenomeneve negative në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale. Është i nevojshëm përfitimi i përvojës nga vendet me sisteme të avancuara të luftës ndaj këtyre efekteve negative si edhe bashkëpunimi me autoritetet

përkatëse në këtë fushë, veçanërisht me shtetet fqinjë nëpërmjet territorit të cilave mallrat hyjnë në tregun e brendshëm.

Lidhur me këtë institucion, Strategjia propozon:

- a) **Personeli:** Të caktohen dhe të kualifikohen specialistë profesionistë brenda stafit të policisë, ku objekti specifik i punës së tyre do të jetë identifikimi dhe hetimi i veprave penale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale dhe intelektuale. Propozimi përcakton krijimin e një strukturë të mirëfilltë, me shtrirje në departamentet e policisë lokale, të cilat duhet të kenë kompetenca që të ndërhyjnë në rastet e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale.
- b) **Trajnimi i punonjësve të policisë:** Rritja e kapaciteteve teorike dhe praktike nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në programet e trajnimeve të organizuara nga DPPM-ja si dhe ZSHDA lidhur me të mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale dhe intelektuale. Në Aneksin XX bashkëngjitur dokumentit jepen shëmbuj të moduleve të mundshme të trainimeve që mund të organizohen nga këto institucione. .
- c) **Pajisjet teknike:** Rritja e investimeve në përmirësimin e teknologjive të reja të informacionit të përdorura nga specialistët e Drejtorisë së Policisë të angazhuar në identifikimin dhe hetimin e çështjeve lidhur me mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale dhe intelektuale; Konsolidimi i një rrjeti të brendshëm kompjuterik të informacionit midis institucioneve që garantojnë zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, duke përfshirë DPPM, ZSHDA-në, Inspektoratin e Tregut për PI-në, Doganat, etj .

Bashkëpunimi ndërkombëtar: Nëpërmjet Memorandumeve të Bashkëpunimit apo marrëveshjeve të posaçme të nxitet bashkëpunimi ndërkombëtar/rajonat midis autoriteteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare lidhur me çështjet e mbrojtjes së DPI; krijimi i një rrjeti rajonal të shkëmbimit të informacionit, duke përfshirë dhe kombinuar bazat elektronike të të dhënave. Për këtë, është e nevojshme të kërkohej asistencë e institucioneve të BE-së.

- a) **Kuadri ligjor:** Pjesëmarrje aktive në ndryshime legjislative në lidhje me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, për të shprehur dhe për të përcaktuar më mirë detyrimet dhe përgjegjësitë që duhet të kenë strukturat e policisë për sa i përket shkeljeve të PI-së.
- b) **Komunikimi ndërinstitutional:** Organizimi i takimeve apo forumeve periodike midis Drejtorisë së Policisë dhe institucioneve të përfshira në mbrojtjen e DPI, ku të trajtohen çështjet e përmirësimit të mundshëm të procedurave, përditësimit dhe shpejtësisë së komunikimit të informacionit për rregjistrimet e reja të të drejtave të autorit, patentave, markave, etj. Këto forume të konceptohen si vazhdimësi e tryezes së bashkëpunimit për vetë kësaj Strategjie.

3.2.2.5. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Degët Doganore janë njoftuar për ndryshimet e kuadrit ligjor nëpërmjet VKM-së nr. 547 datë 1 maj 2008, me fokus kompetencat e autoriteteve doganore. Janë përcaktuar fushat e interesit dhe të fokusit për të gjitha degët doganore. Vëmendje i është kushtuar në veçanti problemit të shkëmbimit të informacionit mes vetë doganave si dhe midis punonjësve të doganës, zotëruesve të të drejtës, punonjësve të policisë dhe gjykatave.

Me urdhër të autoriteteve doganore drejtuese, degët duhet të monitorojnë plotësimin e Deklaratës Doganore (nr. 31), në të cilën markat tregtare duhet të përmenden qartë.

Përpunimi i planit të punës për këtë sektor është duke u kryer. Plani i punës duhet të përditësohet në mënyrë periodike dhe duhet të jetë i përqëndruar në çështjet e ndryshme problematike. Plani i punës nuk është hartuar ende.

Ashtu si Drejtoria Kundër Krimin Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, edhe Administrata Doganore do të vazhdojë të luajë një rol thelbësor në zbatimin e ligjit në fushën e pronësisë intelektuale dhe industriale. Për shkak të ngjshmerisë së problematikave, edhe në këtë rast, Strategjia propozon:

Personeli: Të rritet numri i profesionistëve në stafin e administratës doganore dhe të merren masa për stabilizimin e tyre.

Trajnimi: Pjesëmarrja aktive e punonjësve të doganës në programet e trajnimeve të organizuar nga DPPM-ja dhe ZSHDA. Është shumë e rëndësishme që niveli i njohurive të punonjësve të doganës të përfshirë në zbatimin e të drejtave të PI-së të rritet.

d) Bashkëpunimi ndërkombëtar:

- Të nxitet bashkëpunimi ndërkombëtar/rajonal midis autoriteteve të doganës dhe organizatave ndërkombëtare ose kombëtare dhe të përqëndrohet vëmendja në shkëmbimin e informacionit dhe praktikave të mira me qëllim rritjen e efikasitetit të përgjithshëm të rezultatëve të dëshiruara.
- Të krijohet rrjeti rajonal, duke përfshirë bazat elektronike të të dhënave, për një shkëmbim më të mirë të informacionit dhe përvojës. Nevojitet asistencë e institucioneve të BE-së.
- Trajnimi i punonjësve të doganës në bashkëpunim me autoritetet doganore nga vendet e BE-së, në veçanti nga vendet e reja të BE-së, të cilat kanë një përvojë më të mirë me situatën përpara aderimit në BE dhe më pas.

e) Magazina (t) doganore: Përshtatja e hapësirave magazinuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave edhe për mallrat e bllokuar që cenojnë të drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale. Ndërkohë, procedurat standarte të kësaj administrate si mbikqyrja dhe plumbosja e mallrave të bllokuara deri në vendimin përfundimtar të gjykatës për shkatërrimin e tyre, konsiderohet me se i mjaftueshëm.

f) Kuadri ligjor:

- vlerësimi potencial i krijimit të një seksioni të specializuar në mosmarrëveshjet për të drejtat e PI, pas përcaktimit të statusit të ProjektLigjit për "Për gjykimin e

mosmarrëveshjeve administrative dhe organizimin e drejtësisë administrative” i cili aktualisht është në diskutim në parlamentin shqiptar,

- Promovimi i pjesëmarrjes të institucioneve që janë të angazhuara me çështjet e të drejtave të pronësisë intelektuale, në diskutimin për projekt-ligjet/projekt V.K.M-të të cilat parashikojnë të ndërhyjnë në një procedure që zhvillohet në doganë si dhe në ndryshimet që parashikohen në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe Gjykatën Administrative. Aktualisht behet fjale për ndryshimet ligjore të propozuara (iniciative e Ministrisë së Financave) në Kodin Doganor dhe V.K.M-se nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “ Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar.

g) Bashkëpunimi ndërinstytucional: Komunikim më i mirë me institucionet e tjera të përfshira në zbatimin e të drejtave të PI-së por edhe ato institucione të cilat nuk e kanë prioritet mbrojtjen e të drejtave të PI por e trajtojnë atë si përfaqësuese të grupeve të interesave të caktuara; krijimi dhe konsolidimi i një rrjeti të aksesueshëm nga të gjitha institucionet e përfshira dhe përfshirja e informacionit të nevojshëm (regjistrat e të drejtave të PI-së, regjistrin e të drejtës së autorit, informacion për taksat).

h) Ndërgjegjësimi: Nisja e veprimeve promociionale (e sugjeruar kjo edhe në vitin 2008) me qëllim ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me mallrat e falsifikuara, piraterinë dhe sanksionet e vendosura në këtë fushë. Duhet të përgatitën postëra dhe broshura për të promovuar të drejtat e pronësisë industriale dhe t’u shpërndahen Dhomës së Tregtisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave. Mesazhi i promociionit është mënyra e zbatimit të të drejtave nga ana e zotëruesve të tyre dhe si mund t’i ndihmojnë ata Autoritetet Doganore në luftën kundër mallrave të falsifikuar. Gjithashtu, është me se e rëndësishme që të shtohet transparenca e proceseve rregullta që zhvillon Autoriteti Doganor, duke nënkuptuar në këtë rast publikimin e veprime që D.P.D-ja do t’i vlerësojë sipas rastit për rendësinë e tyre

Rekomandohet shumë bashkëpunimi i ngushtë me policinë dhe Ministrinë e Drejtësisë.

3.2.2.6. Ministria e Drejtësisë

Lidhur me këtë institucion Strategjia propozon vazhdimin e procesit të ndryshimit të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale me qëllim forcimin e pozitës së zotëruesve të të drejtave të PI-së. Procesi ka filluar dhe Ministria duhet të sigurojë që projekt ligjet të kalojnë procedurën sa më shpejt të jetë e mundur. Afati kohor: 1 vit

Ashtu siç është përmendur edhe me pjeset me sipër të dokumentit, krijimi i gjykatës administrative është një proces që po vazhdon dhe do të finalizohet me miratimin në parlament. Me kalimin e projekt ligjit për krijimin e kësaj gjykatë, Strategjia propozon nisjen e punës për vlerësimin e potencialit të krijimit të një seksioni të posaçëm brenda kësaj gjykatë, i cili do të jetë kompetent për trajtimin e çështjeve të të drejtave mbi pronësinë intelektuale.

Në bashkëpunim me DPPM-në dhe ZSHDA-në të nisë fushatën e marrëdhënieve me publikun për të mbështetur ndërgjegjësimin e publikut në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale, mbrojtjes dhe zbatimit të tyre. Afati kohor: 1 vit

Bashkëpunimi i vazhdueshëm i Ministrisë me Shkollën e Magjistraturës si dhe me DPPM apo ZSHDA për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për çështjet e DPI Gjithashtu nevojitet trajnim shtesë në procesin e vendimmarrjes në çështjet e PI-së – rekomandohet shumë bashkëpunimi me institucionet e BE-së (OHIM, ECJ dhe Gjykata e Përgjithshme) dhe/ose me gjyqtarët (prokurorët) nga shtetet anëtare të BE-së (veçanërisht nga Gjermania dhe MB-ja).

3.2.2.7. Prokuroria

Prokuroria ushtron ndjekjen penale, përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit si dhe kryen detyra të tjera të caktuara me ligj. Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar. Pozicioni procedural dhe asistenca e prokurorëve në luftën kundër shkeljeve të PI-së do të ishin më cilësore, nëse do të bëheshin ndryshimet e duhura në Kodin Penal (nënë 148 dhe 149) dhe në Kodin e Procedurës Penale (nënë 58, 59, dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale). Nga këto ndryshime rritet efektiviteti i ndjekjes penale pasi ky proces bëhet (ex officio) për këto vepra si dhe sigurohet një mbrojtje më e fortë për pronësinë intelektuale. Organet e policisë gjyqësore janë në shërbim të prokurorit për ushtrimin me efikasitet të ndjekjes penale

3.2.2.8. Shkolla e Magjistraturës

Me krijimin e Gjykatës Administrative, pas miratimit në parlamentin shqiptar dhe miratimit nga Presidenti, ky Institucion duhet të rrisë angazhimin e vet në trajnimin e gjyqtarëve që do të angazhohen në gjykatën administrative, dhe në mënyrë të veçantë me ata që do të merren në mënyrë specifike me çështjet e DPI. Kjo do të kërkojë në të njëjtën kohë bashkëpunimin e Shkolles së Magjistraturës me DPPM dhe ZSHDA.

Në Programin e Kualifikimit të Vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë si dhe në programin bazë për kandidatet për gjyqtarë dhe prokurorë, Shkolla duhet të përqëndrohet edhe në të drejtat e pronësisë intelektuale dhe të drejtat e autorit në mënyrë që të rritet ekspertiza e gjyqtarëve dhe prokurorëve në këtë fushë. Duhet të përfshihen programet e mëposhtme:

- a) Pronësia Industriale, kuadri ligjor, institucionet e përfshira dhe aktivitetet e tyre, praktika e gjykatës në lidhje me konfliktet që burojnë nga shkelja e të drejtave të markave, patentave dhe dizenjove industriale, duke përfshirë juridiksionin e ECJ-së. Legjislacioni për doganat në lidhje me piraterinë e mallrave dhe produkteve.
- b) E drejta e autorit, procedurat administrative për mbrojtjen dhe administrimin e të drejtave të autorëve dhe procedurat e gjykatës. Procedurat e gjykatës në lidhje me konfliktet që lindin nga shkelja e të drejtave që burojnë nga ligji për të drejtën e autorit.
- c) Legjislacioni i BE-së në lidhje me pronësinë intelektuale dhe të drejtën e autorit, vendimet e OHIM-it, Gjykatës së Përgjithshme dhe ECJ-së në këtë fushë. Rekomandohet (ekspertet) bashkëpunimi me DPPM-në dhe ZSHDA-në.

3.2.2.9. Inspektorati i tregut për pronësinë intelektuale

Aktualisht nuk ka asnjë Inspektorat të Tregut të përqëndruar në inspektimin e shkeljeve të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe të drejtave të autorit në tregun e brendshëm. Ekzistojnë disa inspektime (inspektoratë) të ndryshëm të varur nga Ministrinë përkatëse, por asnjë prej tyre nuk bën inspektim në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale në tregun e brendshëm.

Në periudhen e hartimit të kësaj Strategjie, parlamenti shqiptar ka nisur punën për hartimin e një Ligji të posaçëm “Për Inspektimin”. Për shkak të rezultatëve pozitive të përfuara nga institucione të ngjashme në vende të ndryshme të BE-së (për shëmbull në Republikën Çeke, Gjermani, Austri) si edhe për shkak të boshllëkut në praktikën aktuale të zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, është shumë i këshillueshëm krijimi i këtij organi të veçantë edhe në Shqipëri. Modele të tjerë që duhen konsideruar janë ai serb dhe polak. Administrata Doganore aktualisht është aktive në kufijtë Shqiptarë. Punonjësit e doganës zakonisht nuk kanë kompetenca për të vepruar (për të kontrolluar situatën) në brendësi të kufirit. Nëse ndonjë produkt i falsifikuar kalon nëpërmjet kufirit pa u zbuluar nga punonjësit e doganës, sipas legjislacionit në fuqi, vetëm policia mund ta ndjekë dhe ta bllokojë produktin. Është e qartë se Inspektorati i Tregut për Pronësinë Intelektuale ka një potencial të madh në mbështetjen e ZSHDA-së, Doganave dhe Policisë në veprimet për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Duke pasur parasysh që është duke u zhvilluar një koncept për Reformën e Inspektoriatëve, vendimi përfundimtar do të merret në përputhje me këtë Reformë. Propozimi ekzistues për një rishikim të plotë të sistemit shqiptar të inspektimit duhet të merret në konsideratë gjatë shqyrtimit të ngritjes së Inspektoratit të ri të Tregut për PI-në. Pozicioni dhe struktura përfundimtare e Inspektoratit të Tregut për PI-në duhet të jetë në përputhje me kompetencat dhe pozicionet e inspektoratëve të tjerë.

Sapo të jetë ngritur Inspektorati i ri i Tregut për Pronësinë Intelektuale, duhen organizuar trajnime të inspektorëve të tij në fushën e pronësisë intelektuale, në bashkëpunim me DPPM-në dhe ZSHDA-në.

Institucione të tjera të përfshira

3.2.2.10. Ministria e Arsimit

Ky institucion luan një rol thelbësor në krijimin dhe forcimin e ndërgjegjshmerise qytetare në çështjet e të drejtave të pronësisë intelektuale. Pikerisht, ndërgjegjësimi i publikut si dhe arsimimi në këto çështje janë ndër shtyllat kryesore të kësaj strategjie. Sa më i lartë të jetë informimi i konsumatorit për rëndësinë dhe rolin e të drejtave të PI-së, aq më i ulët do të jetë niveli i piraterisë dhe shkeljeve të tjera në vend. Për sa i përket propozimeve në këtë seksion të Strategjisë, materiali është bazuar në eksperiencën e thelle çeke (Shtojca 5.2 – Eksperiencat e vendeve të ndryshme europiane)

Strategjia propozon që roli i Ministrisë së Arsimit në këtë drejtim të fokusohet në dy drejtime, dhe konkretisht:

1. Rritja e ndërgjegjësimit të nxënësve, studentëve dhe mesuesve për çështjet e të drejtave të pronësisë intelektuale – faza e shpejtë e zbatimit;
2. Përshtatja graduale e kurrikulave mesimore në të gjitha nivelet e arsimit, duke përfshirë në to edhe temat e të drejtave të pronësisë intelektuale – faza e gjatë e zbatimit;

1. Ndërgjegjësimi

Fushatat ndërgjegjësuese që kjo Strategji propozon duhet të plotësohen me masa arsimore në secilin nivel shkollor:

- shkollat nëntëvjeçare: fushata periodike ndërgjegjësimi që bazohen në krijimtarinë e zhvilluar nga vetë nxënësit. Fëmijëve dhe familjeve të tyre duhet t'u përcillen mesazhe të qarta duke përfshirë, për shëmbull “ditet e krijimtarisë” në secilën shkollë.
- shkollat e mesme: përveç elementeve informues, në këto institucione propozohet konsolidimi i masave arsimore që fokusohen në shkeljet e të drejtës së autorit (në muzikë, video lojëra etj.) dhe ndëshkimin e tyre. Kjo gjë mund të zhvillohet në kuadrin e mësimëve të përgjithshme në lëndën e qytetarisë..

2. Kurrikulat Mesimore

Arsimimi i mëtejshëm dhe më i thellë në konceptin e përgjithshëm ndërdisiplinor të mbrojtjes së pronësisë intelektuale duhet të sigurojë administrim të kualifikuar jo vetëm për sektorin e biznesit por edhe për pushtetin qëndror, universitetet, institucionet gjyqësore dhe një sërë institucionesh të tjera aktive në promovimin e të drejtave të këtij lloji. Mësimi i të gjitha lidhjeve në këtë fushë mund të japë një kontribut të rëndësishëm në shfrytëzimin e sinërgjive dhe zhvillimin e ekonomisë së dijes dhe burimeve ekzistuese jo vetëm në nivel kombëtar por edhe europian dhe ndërkombëtar.

Rekomandohet që arsimimi në fushën e PI-së të jetë i lidhur ngushtë me arsimimin për përgjegjësinë e përgjithshme qytetare. Kështu kurrikula duhet të mbulojë për shëmbull temat e mëposhtme:

- Përgjegjësia dhe obligimi qytetar për të kontribuar në mbrojtjen e DPI-ve;
- Përgjegjësia morale dhe ligjore për të denoncuar rastet e abuzimit, vjedhjes, ndryshimit ose kopjimit të veprave, risive dhe të drejtave të pronësisë intelektuale të të tjerëve, qofshin këta shqiptarë apo të huaj;
- E drejta për t'iu drejtuar institucioneve përgjegjëse me qëllim denoncimin e rasteve të shkeljeve të DPI-ve.

Ministria e Arsimit duhet të shikojë me përparësi krijimin e kurrikulave specifike në Fakultetin e Ekonomisë, Fakultetin e Drejtësisë, Universitetin Politeknik, etj. Gjithashtu e rëndësishme është që këto kurrikula të adoptohen edhe nga universitetet privatë.

Hartimi i këtyre kurrikulave dhe zbatimi i tyre duhet të koordinohet me DPPM-në dhe ZSHDA-në nën përgjegjësinë e përgjithshme të Ministrisë së Arsimit. Gjithashtu rekomandohet që për hartimin dhe miratimin e saktë të kurrikulës të shfrytëzohet eksperiencia e Institutit për Zhvillimin Arsimor (IZHA).

Universitetet duhet të adoptojnë gradualisht edhe mundësi për studime pasuniversitare si dhe doktoratura në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale.

3.2.2.11. Keshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

KKRT-ja bashkëpunon me ZSHDA-në dhe me grupe të tjera interesi, si Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Agjencitë e Administrimit Kolektiv, për çështje që përfshijnë të drejtat e autorit dhe të drejtat përkatëse që lidhen me to, shkëmbimin e informacionit, verifikimin e vërtetësisë dhe ligjshmërisë së kontratave, ndjekjen e ankimeve për transmetimet e ndryshme të jashtëligjshme etj.

Duhet të specifikohet që aktualisht është duke u përpiluar një ligj i ri për median audiovizuale, i cili do të shfuqizonte ligjin nr. 8410.

Nga analiza e kryer, Strategjia identifikon se nuk ka ndonjë nevojë të veçantë për ndryshim në KKRT. Nëse KKRT-ja i plotëson detyrimet e caktuara nga ligji në fuqi, roli i tij thelbësor në zbatimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, duke përfshirë bashkëpunimin me ZSHDA-në, i përmbush kërkesat.

3.2.2.12. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të konsiderohet si pjesë e procesit të zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale për sa i përket vjeljes së saktë të taksave. Gjatë procedurës së vjeljes së taksave Drejtoria (punonjësit e saj) mund të marrin informacion për pastrim parash, mashtrim dhe/ose mallra të falsifikuar. Prandaj punonjësit e tatimeve duhet të bashkëpunojnë ngushtë me Doganat dhe Policinë, që është detyra e tyre kryesore në strategjinë për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

3.2.2.13. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Funksioni kryesor i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit është koordinimi dhe këshillimi i projekteve për teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në administratën publike, zhvillimi i rrjetit të brendshëm për administratën publike (GOVNET dhe portali i qeverisë), promovimi i përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe përfundimi i kuadrit ligjor. Agjencia duhet të ketë një funksion këshillimor dhe të bashkëpunojë ngushtë me ZSHDA-në, AKEPI-indhe DPPM-në për sa i përket pronësisë intelektuale në fushën e shoqërisë së informacionit.

3.2.2.14. Zyrat e Liçencimit

Bashkëpunimi me autoritetet e licencimit kryhet kryesisht në nivel rajonal. Punonjësit e zyrës së liçencimit mund të marrin pjesë në veprimet e përbashkëta të kontrollit si ato në lidhje me shitjen në tëzga dhe metodat e ngjashme me kërkesë të administrates doganore, policisë ose Inspektoratit të Tregut. Përvojat dhe gjetjet e tyre po përdoren në procesin e vendimmarrjes brenda kuadrit të kompetencave të tyre (dhënies së liçencave).

3.2.2.15. Ambasadat e shteteve të huaja

Në këtë kontekst rekomandohet që të vendoset një bashkëpunim i mirë dhe efikas me ambasadat. Në shumë raste departamentet e tyre të tregtisë janë të interesuar të informohen për shkeljet e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe, në bashkëpunim me të gjitha subjektet e sipërpërmendura organizojnë seminare në lidhje me përvojat e huaja në fushën në fjalë si edhe nxisin bashkëpunimin me partnerë privatë kryesorë, veçanërisht prodhues botërorë nga vendet interesat e të cilave ato përfaqësojnë.

3.2.2.16. Dhomat e Tregtisë / Bashkimi i Dhomave të Tregtisë

Suksesi në zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale nuk mund të imagjinohet pa bashkëpunimin aktiv me subjektet, të drejtat e të cilave përmenden në këtë kontekst. Si rregull, zotëruesit kryesorë të të drejtave në fjalë, qofshin vendas apo të huaj, si Dhoma e Tregtisë, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, Bashkimi Kundër Piraterisë, administruesit kolektivë të së drejtës së autorit, Federata Ndërkombëtare e Prodhuesve të Pijeve Alkoolike dhe shumë të tjerë, marrin pjesë në këto aktivitete.

Është e rëndësishme që sektori publik të kontribuojë të paktën me anë të aktivitetit të tij organizativ, në mënyrë që institucionet që synojnë të përmirësojnë situatën në fushën e pajtimit dhe zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale të kenë mbështetje dhe bashkëpunim afat-gjatë dhe aktiv. Këto subjekte duhet të përfshihen në aktivitetet edukative në varësi të përshkrimit të tyre të punës. Veçanërisht, Dhomat e Tregtisë duhet të promovojnë në mënyrë më aktive të drejtat e PI-së, mbrojtjen dhe zbatimin e tyre brenda sektorit të biznesit. Prandaj rekomandohen seminare dhe leksione nga ekspertet.

3.2.3. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i institucioneve

Bashkëpunimi midis institucioneve individuale përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në rastin e autoriteteve publike, duhet të bazohet vetëm në faktin se secili prej autoriteteve administrative zbaton aktivitetet që synojnë plotësimin e interesave të publikut të ushtruara nga autoriteti i veçantë, ndërkohë që autoritetet individuale veprojnë në mënyrë të tillë që t'i mundësojnë dhe t'i lehtësojnë njëri-tjetrit zbatimin e sferës konkretë të autoritetit dhe kompetencës në përputhje me qëllimin përkatës.

Një tipar i veçantë i interesit publik të ushtruar nga autoritetet individuale të përfshira në sistemin e zbatimit të të drejtave të pronësisë individuale është fakti që interesat publike të kërkuara nga autoritetet individuale nuk duhet të jenë kontradiktore. Interesi i përbashkët publik në lidhje me të gjitha aktivitetet e kryera nga këto autoritete në fushën përkatëse do të jetë në veçanti parandalimi dhe luftimi i shkeljeve të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe mbrojtja e të drejtave subjektive të zotëruesve individualë të të drejtave të pronësisë intelektuale.

Për sa i përket bazës ligjore për bashkëpunimin, mund të bëhet dallimi nga rasti në rast, ku një formë e bashkëpunimit me autoritetet e tjera të administrates publike vendoset mbi autoritetin e administrates publike direkt me ligj, dhe rastet ku një formë bashkëpunimi (d.m.th. një aktivitet specifik i autoritetit administrativ në bashkëpunim me autoritetin tjetër administrativ) nuk vendoset direkt me ligj, por rezulton në mënyrë indirektë nga misioni statutor i autoritetit duke përfshirë përkufizimin e pushtetit dhe kompetencave; në të gjitha rrethanat, është e nevojshme që të këmbëngulet se çdo formë bashkëpunimi e pranueshme ligjërisht midis autoriteteve administrative duhet të mbulohet nga legjislacioni i vlefshëm të paktën brenda përkufizimit të përgjithshëm të interesit publik, i cili ushtrohet nga autoriteti administrativ në rrjedhën e ekzekutimit të kompetencave që i janë dhënë. Prandaj, fushat e mëposhtme duhet të bashkërendohen në mënyrë të përbashkët:

3.2.4. Ndërgjegjësimi i Publikut

Ndërgjegjësimi i qytetareve është një element thelbësor në mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, që garanton në të njëjtën kohë edhe suksesin e zbatimit të kësaj Strategjie. Në kontekstin e fuqizimit të vazhdueshëm të rolit të mediave në ndërgjegjësimin e publikut, Strategjia propozon marrjen e iniciativave të ndryshme mediatike nga ana e institucioneve përgjegjëse të përmendura më lart për të trumbëtuar çështjet e se drejtës se pronësisë intelektuale. Si të tilla mund të përmenden:

- Promovimi i aktiviteteve të grupeve të ndryshme të interesit (duke përfshirë OJQ-të, shoqatat e biznesit, dhomat e tregëtisë, biznesmenë, studiues, etj) të përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale nëpërmjet mjeteve të diskutimit, ekspozitave, leksioneve etj.
- Nxitja e debatit publik rreth çështjeve aktuale në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale, veçanërisht nga perspektiva e të drejtës ndërkombëtare dhe biznesit ndërkombëtar. Përfshirja e sferës së medias dhe mas medias në bashkëpunim.

Mbështetja e publikut është një element themelor për suksesin e ketyre iniciativave. Kjo mund të arrihet vetëm nëse publiku do të ketë mundësi të njihet me pasojat e padëshirueshme të shkeljeve të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe gjithashtu të kuptojë ndikimin që ato kanë në jetën e tyre. Në këtë kontekst, është e nevojshme jo vetëm që sektori publik t'i mbrojë si duhet të drejtat e zotëruesve të të drejtave individuale, por edhe që publiku i gjerë të kuptojë se blerja e mallrave të imituara ose të falsifikuara çon në përkeqësim të situatës së punësimit, shpesh duke marrë produkte të pa garantuar, duke përfshirë edhe ndikimet në fushën e shëndetësisë dhe higjienës, dhe nxit përfitimet e strukturave të jashtëligjshme në shoqëri.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që të përmbushen këto detyra, pasi i gjithë sistemi i pronësisë intelektuale nuk është i thjeshtë dhe publiku i gjerë zakonisht ka njohuri shumë të kufizuara dhe shpesh të pasakta rreth saj. Gjithashtu, brenda kuadrit të mundësisë ekonomike, publiku shpesh priret të zgjedhë opsionin e marrjes së mallrave me çmimin më të ulët të mundshëm.

Ndërkohë, përveç rolit promovues të menjëhershëm që ka media, sensibilizimi i opinionit lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale duhet të trajtohet në mënyrë strategjike nëpërmjet

ndryshimeve të nevojshme në sistemin arsimor. Në dokumentin me sipër, Strategjia propozon masat që duhet të merren në sistemin arsimor shqiptar, nëpërmjet rivlerësimit të kurrikulave mesimore si dhe përfshirjes në to të të drejtave të pronësisë intelektuale.

KAPITULLI IV

LLOGARIDHËNIA & MONITORIMI

Monitorimi i kësaj strategjie do të kryhet nga Grupi Ndëri-institucional i Punës për drejtimin dhe monitorimin e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Drejtues i këtij grupi do të jetë Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, ndërsa anëtarë do të jenë: zv.ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, zv.ministri i Financave, zv.ministri i Integritimit European, zv.ministri i Drejtësisë, zv.ministri i Brendshëm, zv.ministri i Arsimit, zv.ministri i Inovacionit, Teknologjisë dhe Informacionit dhe Komunikimit, Kryetari i Këshillit të Radios dhe Televizionit.

Në takimet e këtij komiteti marrin pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Drejtori i Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA), Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, Drejtori I Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Ky Grup Ndërinstitucional monitoron zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe të bashkërendojë vendimmarrjen politike për çështje lidhur me këtë strategji.

Sekretariati teknik për Grupin Ndër-institucional të Punës do të jetë Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave pranë METE, e cila do të bashkëpunojë ngushtësisht me institucionet e tjera, sidomos me Zyrën Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA). Sekretariati teknik do të:

- a. monitorojë zbatimin e masave të parashikuara në planin e veprimit të kësaj strategjie;
- b. mbledhë çdo gjashtë muaj informacion nga institucionet shtetërore, të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për masat respektive që ato kanë në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie; si dhe
- c. përgatisë dy raporte në vit, përkatësisht gjashtë mujor dhe 1 vjeçar, për ecurinë e zbatimit të masave të strategjisë për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Raportet 6 mujore dhe 1 vjeçare i paraqiten Grupi Ndërinstitucional të Punës nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës. Grupi Ndërmintor diskuton për zbatueshmërinë e masave dhe problematikën e lidhur me to, si dhe merr vendime për çështje institucionale.

Institucionet përgjegjëse do të raportojnë pranë METE mbi nivelin e zbatimit të masave në strategjinë dhe planin e veprimit për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, problematikën e zbatimit të tyre si dhe rekomandime për përmirësimin e situatës. Po ashtu, do të dërgohen të dhëna relevante për analizën e inspektimeve të kryera për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Sekretariati teknik do të hartojë metodologjinë e raportimit sipas një formati të standardizuar.

Progresi i ecurisë së strategjisë do të matet në bazë të disa treguesve për masat e parashikuara, të cilat janë:

- Numri i akteve ligjore të ndryshuara në afatin përkatës;
- Numri i fushatave të ndërgjegjësimit për të drejtat e pronësisë intelektuale
- Numri i çështjeve në Gjykatën administrative për të drejtat e pronësisë intelektuale
- Numri i subjekteve të gjobitura për çështje të së drejtës së pronësisë intelektuale
- Numri i personave të trajnuar (gjykatës e prokurorë) për të drejtat e pronësisë intelektuale

KAPITULLI V

PLANI I VEPRIMIT

STRATEGJIA PER ZBATIMIN E TE DREJTAVE TE PRONESISE INTELEKTUALE

Plani i mëposhtëm i veprimit është krijuar ne kuader te zbatimit politikave qe propozon Strategjia, te konceptuar për një periudhë afatmesme (2 vjet, 2012) dhe për një periudhë afatgjatë (5 vjet, 2015). Ne baze te ketij plani te integruar, Strategjia sugjeron qe çdo Ministri apo institucion tjetër i angazhuar ne çeshtjet e te drejtave te pronesisë intelektuale, te konceptoje dhe te miratoje planin e vet te veprimit. Masat qe paraqet Plani ne vazhdim duhet te merren ne konsiderate dhe te rivlerësohen në dritën e specifikave të secilës ministri dhe secilit institucion.

Buxheti tregues i donatorëve merr në konsideratë kostot standarde për aktivitetet e ngjashme të zbatuara në kuadrin e projekteve në fushën e PI-së. Kostot treguese që do të mbështeten nga buxheti përputhen në thelb me rekrutimin e personelit të ri.

PLANI I VEPRIMIT

Objektivat strategjike	Masat institucionale	Institucioni (et) drejtues/bashkëpunues	Indikatoret	Afati kohor	Financimi (Lekë)
Përfundimi i kuadrit legjislativ dhe rregullator	Ligji i ri për inspektoratin e tregut për PI-në	ZSHDA / DP Policisë së Shtetit / Ministria e Drejtësisë	Ligji i hartuar dhe që i është dërguar parlamentit (2011)	2011	Kosto administrative
	Miratimi i ligjit të ri për Inspektoratin e Tregut për PI-në		Projekt ligji i miratuar nga parlamenti	2012	
	Ratifikimi i Marrëveshjes së Londrës	DPPM	1 projekt ligj / Projekt ligji dërgohet parlamentit (2011) / ratifikimi (2012)	2012	Kosto administrative
	Ligji i ri për të drejtën e autorit	ZSHDA	Dorëzimi në parlament / (2011) / Miratimi i ligjit (2011)	2011	Kosto administrative
	Kodi penal	Ministria e Drejtësisë / ZSHDA	1 projekt ligj / Dorëzimi në parlament / (2011) / Miratimi i ligjit	2011	Kosto administrative
	Revision of Law 8410, 8096 and DCM 547	Ministria e Drejtësisë / ZSHDA	1 projekt ligj (2011) / Dorëzimi në parlament dhe miratimi (2012)	2012	Kosto administrative
	Rishikimi i Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale (me Ministrinë e Drejtësisë) dhe rishikimi i ligjit “Për Policinë e Shtetit” për një përcaktim më që qartë të roleve	Ministria e Drejtësisë / DP Policisë së Shtetit / DP Doganave / ZSHDA	1 projekt ligj / Dorëzimi në parlament / (2011) / Miratimi i ligjit	2011	Kosto administrative
	Rishikimi i Kodit Penal (me Ministri-në e Drejtësisë) dhe projekt vendimi për disa ndryshime në VKM 547	Ministria e Drejtësisë / DP Policisë së Shtetit / DP Doganave / ZSHDA	1 projekt ligj / Dorëzimi në parlament / (2011) / Miratimi i ligjit	2011	Kosto administrative
	Marrja e analizës së IZHA-s dhe hartimi i kurrikulës për	IZHA / DPPM / ZSHDA	Analiza e nevojave / Hartimi i kurrikulës për secilin nivel shkollor (2011)	2011	

	arsimimin rreth PI-së				Donatorët: 40 500 000 Lekë* (300 000 €)
Forcimi institucional	Qeveria i ka dhënë zyrtarisht ZSHDA-së mandatin për të koordinuar axhendën kombëtare për pronësinë industriale	ZSHDA	Projekt ligj ose dekret (2011) / Miratimi (2012)	2012	
		DPPM/Ministria e Financës	Studim i standardeve, studim i fizibilitetit, projekt (2011) /	2012	Kosto administrative
	Trajnimi i personelit të DPPM-së	DPPM	Kurrikula dhe dokumentacioni i trajnimit, rritja e njohurisë (2011) / Numri i personelit të trajnuar në mënyrë efikase, përqindja e arritjes së kurrikulës (2012)	2012	Donatorët: 283 500 000 Lekë (2 100 000 €)
	Vlerësimi i IT-së: <ul style="list-style-type: none"> • hartimi i shërbimeve elektronike • vendimet në bazën e të dhënave • kuadri ligjor për publikimin regjistrimi në linjë (<i>on line</i>) 	DPPM	Mjedis i zgjeruar i IT-së, termat e referencës (2011), shtimi i shërbimeve në linjë (<i>on line</i>) (2012) / Realizimi efikas i sistemit të ri,	2012	Donatorët: 189 000 000 Lekë (1 400 000 €)
		ZSHDA / Ministria e Financës	Studim i standardeve, studim i fizibilitetit, projekt (2011) / Vendim i Këshillit të Ministrave (2012)	2012	
		ZSHDA	Përshkrimet e reja të punës, fushata e rekrutimit / Numri real i personelit të ri të punësuar (2012)	2012	
	Shtimi i personelit për periudhë afatshkurtër (nw pwrputhjw mw ligjin e inspektimit)	ZSHDA	Përshkrimet e reja të punës, fushata e rekrutimit / Numri real i personelit të ri të punësuar (2015)	2013	
	Shtimi i personelit për periudhë afatgjatë (nw pwrputhjw mw ligjin e inspektimit)	ZSHDA	Krijimi, punësimi i personelit, pajisja dhe funksionimi i qendrave (2015)	2012	

	<p>Krijimi i 8 qendrave rajonale duke përfshirë qendrat ekzistuese (nw pwrputhjw mw ligjin e inspektimit)</p>	<p>ZSHDA</p>	<p>Krijimi, punësimi i personelit, pajisja dhe funksionimi i qendrave (2015)</p> <p>Standardet e BE-së, kurrikula e trajnimit (2011) / Trajnimi i personelit (2011)</p>	<p>2015</p>	<p>Donatorët: 81 000 000 Lekë (600 000 €)</p>
	<p>Krijimi i 4 qendrave të tjera rajonale (nw pwrputhjw mw ligjin e inspektimit)</p>	<p>ZSHDA</p>	<p>Caktimi i personelit në secilin seksion për ndjekjen e kurrikulës për PI-në (2011) / Shtimi i numrit të personelit të emëruar me kalimin e viteve</p>	<p>2015</p>	
	<p>Zhvillimi i aftësive dhe shërbimeve të ndërmjetësimit në ZSHDA</p>	<p>DP Policisë së Shtetit</p>	<p>Shtimi i numrit të personelit të trajnuar me kalimin e viteve / numri i kurrikulave të ndjekura (2011)</p>	<p>Nga viti 2011 deri në vitin 2013</p>	
	<p>Kualifikimi i personelit për PI-në</p>	<p>DP Policisë së Shtetit / DPPM / ZSHDA</p>	<p>Termet e referencës dhe ofrimi i bazave të të dhënave të DPI-ve për pajisje të lëvizshme (2011 – 2014) / Shkëmbimi i praktikave më të mira me vendet e tjera (2012)</p>	<p>Nga viti 2011 deri në vitin 2015</p>	
	<p>Trajnimi i i punonjësve në bashkëpunim me DPPM-në dhe ZSHDA-në</p>	<p>DP Policisë së Shtetit</p>	<p>Numri i magazinave të disponueshme (2012)</p>	<p>Nga viti 2011 deri në vitin 2014</p>	
	<p>Pajisje teknike të IT-së</p>	<p>DP Doganave / DPPM / ZSHDA</p> <p>DP Doganave / DPPM /</p>	<p>Termet e referencës dhe ofrimi i pajisjeve të lëvizshme (2011 Aksesi në të dhënat kryesore dhe të bazat e të dhënave të DPI-të (2013) / Shkëmbimi i praktikave më të mira</p>	<p>Donatorët: 116 100 000 Lekë (860 000 €)</p>	

	<p>Kualifikimi i personelit për PI-në</p> <p>Krijimi i magazinës (magazinave) doganore</p> <p>Trajnimi i punonjësve të tatimeve në bashkëpunim me DPPM-në dhe ZSHDA-në</p> <p>Gjyqtarët dhe prokurorët ndjekin trajnime fillestare dhe të avancuara të organizuara nga ekspertë të DPPM-së dhe ZSHDA-së</p> <p>Hartimi i kurrikulës së avancuar për magjistratët dhe prokurorët</p>	<p>ZSHDA</p> <p>DP Doganave / DPPM / ZSHDA</p> <p>DPPM / ZSHDA / Ministria e Drejtësisë / Shkolla e Magjistraturës</p> <p>Shkolla e Magjistraturës DPPM / ZSHDA</p>	<p>me vendet e tjera (2013)</p> <p>Analiza e nevojave (2011) Zhvillimi i kurrikulës dhe dokumentacionit të trajnimit (2011) / Numri i personelit të trajnuar (2011)</p> <p>Analiza e nevojave (2011) Zhvillimi i kurrikulës dhe dokumentacionit të trajnimit (2011) / Numri i personelit të trajnuar (2011)</p>	<p>2012</p> <p>Nga viti 2011 deri në vitin 2014</p> <p>Në vazhdim që nga viti 2011</p> <p>Në vazhdim që nga viti 2011</p>	<p>Donatorët: 23 625 000 Lekë (175 000 €)</p>
<p>Bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërinstitucional</p>	<p>Krijimi i një grupi ndërinstitucional për monitorimin e strategjisë</p> <p>Trajnimi i autoriteteve të zbatimit të ligjit për PI-në: është përcaktuar dhe zbatuar kurrikula për vitin e parë</p> <p>Bashkëpunim me DPPM-në</p>	<p>MIE / DPPM / ZSHDA / Ministria e Drejtësisë / Ministria e Arsimit/DP Policisë së Shtetit / DP Doganave</p> <p>DPPM / ZSHDA</p> <p>DPPM / ZSHDA</p>	<p>Dekret (2011)</p> <p>Analiza e nevojave, zhvillimi i kurrikulës (2011) / grupet e para vjetore të të trajnuarve (2011)</p> <p>Analiza e nevojave, zhvillimi i kurrikulës (2011) / grupet e para vjetore të të trajnuarve (2011)</p>	<p>2011</p> <p>2011</p> <p>2011</p>	

	<p>për programin e ndërgjegjësimit për autoritetet e zbatimit të ligjit, faza e krijimit dhe zbatimit</p> <p>Krijimi i një mekanizmi të vazhdueshëm për forcimin e bashkëpunimit me agjencitë e administrimit kolektiv</p> <p>Ngritja e grupit të punës për shkeljet në internet me AKSHI-në dhe KKRT-në</p> <p>ZHSDA-ja ofron mbështetje për AKSHI-n dhe KKRT-në për monitorimin e fushave të tyre të tregut</p> <p>Zhvillimi i bashkëpunimit rajonal</p>	<p>DPPM / ZSHDA</p> <p>ZHSDA / AKSHI / KKRT</p> <p>ZSHDA</p> <p>DP Policisë së Shtetit</p>	<p>Memorandume mirëkuptimi (2011) / Shpeshësia e takimeve më pak se një vit (2011)</p> <p>Termet e referencës për grupin e punës (2011) / Memorandume mirëkuptimi (2011) .</p> <p>Memorandume mirëkuptimi (2013) / Shpeshësia e takimeve më pak se një vit (2013)</p> <p>Nënshkrimi i memorandumeve të mirëkuptimit me institucione të ngjashme në shtetet fqinje (2012) / Shkëmbimi i të dhënave (2015) / Seanca të përbashkëta rajonale trajnimit (2012) / Shpeshësia e takimeve të përbashkëta të vlerësimit (2012)</p>	<p>2011</p> <p>2011</p> <p>2013</p> <p>Në vazhdim nga viti 2011 Shkëmbimi i të dhënave në varësi të ecurisë së DPPM-së dhe ZSHDA</p>	
Ndërgjegjësimi për DPI-të	Trajnimi i autoriteteve të zbatimit të ligjit për PI-në	DPPM / ZSHDA	Grupet vjetore të të trajnuarve / Numri i seancave të trajnimit dhe numri (%) e të trajnuarve	Në mënyrë vjetore, që nga viti 2012	
	“Qendra e parë e informacionit shkencor dhe teknik” e ngritur në Tiranë	DPPM / ZSHDA	Termet e referencës, prokurimi dhe instalimi i pajisjeve (2011) / Qendra do të jetë funksionale (2012)	2012	
	“Qendra e parë e informacionit shkencor dhe teknik” e ngritur në Tiranë, plotësisht funksionale dhe qendra e dytë e ngritur në një rreth	DPPM / Partner lokal	Përdorimi efikas i Qendrës, numri i vizitorëve, i kërkesave për shërbime (2013) / Ngritja e Qendrës së dytë (2014) dhe funksionimi i saj (2015)	2015	

	<p>Është hartuar dhe ka nisur fushata e ndërgjegjësimit të publikut “Kopjimi është krim”</p> <p>Pjesëmarrja në fushatën e ndërgjegjësimit të ZSHDA-së / DPPM-së</p> <p>Marrja e analizës së IZHA-s dhe hartimi i kurrikulës për arsimimin rreth PI-së</p> <p>Miratimi i sistemit të ri arsimor për PI-në</p> <p>Trajnimi i mësuesve që japin PI-në, ose rekrutimi dhe trajnimi i mësuesve të rinj</p>	<p>ZSHDA /DPPM / DP Policisë së Shtetit / DP Doganave / Ministria e Drejtësisë / Ministria e Arsimit</p> <p>ZSHDA /DPPM / DP Policisë së Shtetit / DP Doganave / Ministria e Drejtësisë / Ministria e Arsimit</p> <p>IZHA / DPPM / ZSHDA</p> <p>Ministria e Arsimit</p> <p>Ministria e Arsimit / DPPM / ZSHDA</p>	<p>Plani i komunikimit / Krijimi i grupit ndërinstitucional të punës duke përfshirë median / Përfshirja e partnerëve ndërkombëtarë/(2011) Zbatimi i planit të komunikimit / fushatë në TV, radio, media dhe dokumentacion</p> <p>Shtimi i shikueshmërisë së DP Doganave në luftën kundër piraterisë dhe falsifikimit (2012)</p> <p>Analiza e nevojave / Hartimi i kurrikulës për secilin nivel shkollor (2011)</p> <p>Marrja e vendimit për përfshirjen e kurrikulës së PI-së në kurrikulën e përgjithshme (2012)</p> <p>Trajnimi i mësuesve të parë për zbatimin e kurrikulës (2012) / Ndryshimi i përqindjes së mësuesve të trajnuar (2012) / Ndryshimi i përqindjes së nxënësve që do të përfitojnë nga kurrikula e PI-së (2013)</p>	<p>2011-2015</p> <p>Në vazhdim, që nga nisja e fushatës (2012)</p> <p>2011</p> <p>2012</p> <p>2013</p>	<p>Donatorët: 40 500 000 Lekë (300 000 €)</p>
--	---	---	---	--	---

* kursi i këmbimit 1€ = 135Lekë

KAPITULLI VI

ANEXE

ANEKS 1.

Kuadri kombëtar ligjor për PI-le dhe Acquis të BE-së.

Përafrimi i legjislacionit kombëtar mbi të Drejtat e Pronësisë Intelktuale me Acquis të BE-së është arritur nëpërmjet akteve ligjore të mëposhtme:

- Ligji nr. 9947 datë 7 korrik 2008 **“Për pronësinë industriale”** (Fletorja Zyrtare nr. 121 datë 31.07.2008), i cili ka hyrë në fuqi më 1 nëntor 2008.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1706 datë 29 dhjetor 2008 **“Rregullore për regjistrimin e markave tregtare dhe të shërbimit”** (Fletorja Zyrtare nr. 212 datë 4.02.2009, fq. 11415).
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1707 datë 29 dhjetor 2008 **“Rregullore për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit”** (Fletorja Zyrtare nr. 213 datë 9.02.2009, fq. 11471).
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1705 datë 29 dhjetor 2008 **“Rregullore për regjistrimin e treguesve gjeografikë”** (Fletorja Zyrtare nr. 208, 22.01.2009, fq. 11157).
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 381 datë 8 prill 2009 **“Rregullore për regjistrimin e dizenjove industriale”** (Fletorja Zyrtare nr. 75 datë 22.05.2009, fq. 3329).
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 883 datë 13 maj 2009 **“Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”** (Fletorja zyrtare nr. 134 datë 11.09.2009, fq. 6247)
- Ligji nr. 8488 datë 13 maj 1999 **“Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruar”** (Fletorja Zyrtare nr. 18 datë 18.07.1999, fq. 562; i hyrë në fuqi më 3 gusht 1999). Ky ligj është ndryshuar me ligjin nr. 9957 datë 17 korrik 2008 **“Për disa ndryshime në ligjin nr. 8488 datë 13 maj 1999 ”Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruar”** (Fletorja Zyrtare nr. 123 datë 31.07.2008, fq. 5446; i hyrë në fuqi më 1 nëntor 2008).
- Ligji nr. 9380 datë 4 prill 2005: **“Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të”**.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 232 datë 19 prill 2006: **“Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit”**.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 343 datë 6 qershor 2007: **“Për miratimin e tarifave për shërbimet që ofron Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit”**.
- Ligji nr. 8410 datë 30 shtator 1998: **“Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”** (ligji i ri është duke u hartuar).

Ligji i ri nr. 9947 “Për pronësinë industriale” dhe rregulloret për zbatimin e tij janë përafruar plotësisht me aktet e mëposhtme:

- Konventa Europiane në Fushën e Patentave (EPC 2000),
- Direktiva 89/104/KEE “Mbi markat tregtare dhe të shërbimit” (Fletorja zyrtare e Komunitetit European KE nr. L 40 datë 11.2.1989, fq.1)

- Direktiva 98/44/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 6 korrik 1998 “Për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike” (*Fletorja zyrtare e Komunitetit Europian L 213/13 datë 30.07.1998*).
- Direktiva 98/71/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 13 tetor 1998 “Për mbrojtjen ligjore të dizenjove industriale” (*Fletorja zyrtare e Komunitetit Europian L 289 datë 28.10.1998 fq. 0028-0035*).
- Direktiva 2004/48/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 29 prill 2004 “Për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale” (*Fletorja zyrtare e Bashkimit Europian L 157 datë 30 prill 2004*).
- Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 1768/92 datë 18 qershor 1992 “Për krijimin e certifikatës shtesë për mbrojtjen e produkteve mjekësore” (*Fletorja zyrtare L 182 datë, 02.07.1992, fq. 0001 – 0005*).
- Rregullorja (KE) nr. 1610/96 e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 23 korrik 1996 “Për krijimin e certifikatës shtesë për mbrojtjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve” (*Fletorja zyrtare L 198 datë 8.8.1996, fq. 30-35*).
- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 6/2002 datë 12 dhjetor 2001 “Për Dizenjot Komunitare” (*Fletorja zyrtare L 003 datë 05.01.2002, fq. 0001 – 0024*).
- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 40/94 datë 20 dhjetor 1993 “Për markat komunitare” (*Fletorja zyrtare L 11 datë 14.01.1994, fq. 1-36*).
- Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 2081/92 datë 14 korrik 1992 “Për mbrojtjen e treguesve gjeografikë dhe emërtimet e origjinës së produkteve dhe ushqimeve bujqësore” (*Fletorja zyrtare L 208 datë 24.07.1992, fq. 0001 – 0008*).

Për sa i përket të drejtës së autorit, legjislacioni ekzistues ndjek pjesërisht dispozitat ligjore europiane të mëposhtme:

- Direktiva **93/83/KEE** datë 27 shtator 1993 “Për koordinimin e rregullave për të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të që zbatohen në transmetimet satëlitore dhe ritransmetimet kabllorë – *Celex nr. 31993L0083/ Fletorja zyrtare 1993L248/15*.
- Direktiva **2001/84/KE** e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 27 shtator 2001 “Për të drejtën e rishitjes në dobi të autorit të një veprë arti origjinale” – *Celex nr. 32001L0084/ Fletorja zyrtare 2001 L 272/32*.
- Direktiva **2006/115/KE** e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 12 dhjetor 2006 “Për të drejtën e qirasë dhe huazimit si dhe për disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale” (version i kodifikuar i 92/100/KEE) – *Celex nr. 32006L0115/ Fletorja zyrtare 2006 L 376/28*.
- Direktiva **2006/116/KE** e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 12 dhjetor 2006 “Për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të” (version i kodifikuar i 93/98/KE) – *Celex nr. 32006L0116/ Fletorja zyrtare 2006 L372/12*.
- Direktiva **96/9/KE** e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 11 mars 1996 “Për mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave” – *Celex nr. 31996L0009/ Fletorja zyrtare 1996 L 77/20*.
- Direktiva **2009/24/KE** e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 23 prill 2009 “Për mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike” – *Celex nr. 32009L0024/ Fletorja zyrtare 2009 L 111/16*.

ANEKS II

Standardet në Vendet Anëtare/Kandidate të BE-së: Eksperienca në Çeki, Rumani dhe Kroaci

Eksperienca Çeke në zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale

Hyrje

Në Republikën Çeke dhe më parë në ish-Çekosllovakë, ku Zyra e Patentave dhe gjykata e specializuar e patentave janë themeluar që në vitin 1919, në historinë e saj modernë të zhvillimit të aktiviteteve që kanë si qëllim garantimin e zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, është bazuar për një kohë të gjatë në thellimin gradual të kompetencave dhe në përmirësimin e cilësisë së punës së institucioneve individuale aktive në këtë fushë. Megjithatë, globalizimi, vlera e rritur e aseteve të paprekshme në ekonominë e dijes, synimi për t'u bërë një anëtar i Bashkimit Europian, përgjegjësia për arritjen e kërkesave rigoroze të TRIPS-it, tregoi gradualisht në fillimet e vitëve nëntëdhjetë se trajtimi ekzistues i çështjeve të tilla nuk ishte mjaft efikas dhe se situata kërkon një koordinim të vazhdueshëm mes institucioneve të rëndësishme, përfshirë aktivitetet e sektorit privat.

Si rrjedhojë, në fillimin e vitëve nëntëdhjetë, u firmos një marrëveshje mes autoriteteve administrative qendrore, e cila synonte që të koordinonte përpjekjet për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe kufizimeve të fenomenit negativ përkatës, kryesisht falsifikimit dhe piraterisë së produktit. Si rrjedhojë, marrëveshja u miratua nga disa institucione qendrore, dhe aktualisht, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Industrisë dhe Tregtisë, Ministria e Financave, Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Inspektorati Çek i Tregtisë, Inspektorati Kombëtar i Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Zyra e Pronësisë Industriale, që ka kompetencat e një zyrë për patentat dhe markat tregtare në Republikën Çeke, janë të grupuara këtu.

Qëllimi i këtij koordinimi nuk ishte as krijimi i dokumenteve specifike, as bashkimi i opinionëve dhe as ndarja e detyrave, por ishte në veçanti koordinimi i trajtimeve strategjike të çështjes së zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale. Si rrjedhojë, ky bashkëpunim u mbështet u mbështet fuqishëm nga Rezoluta Qeveritare Nr. 330/1999 që bën fjalë për konceptin e luftës kundër krimit në fushën e pronësisë intelektuale.

Si rrjedhojë, institucionet e sipërpërmendura morën pjesë gjithashtu në projektin e zgjeruar "Zbatimi i pronësisë intelektuale", i cili u financua pjesërisht nga Bashkimi Europian dhe një nga ofruesit më të rëndësishëm mes tyre ishte zyra e ligjit dhe patentave Cermak Horejs Matejka a spol. Rezultati kryesor i kësaj ishte trajnimi i rreth 550 ekspertëve nga sektori publik në këtë fushë në vitin 2004. Secili prej tyre u pajis me tekste mësimi dhe mori pjesë në trajnim për pesë ditë, kryesisht në leksione, por gjithashtu edhe në një seminar. Një rezultat tjetër i rëndësishëm i këtij projekti ishte një bazë e veçantë të dhënash në internet, e cila gjithashtu mund të përdorej vetëm nga sektori publik, pra nga organizatat që kishin të bënin me zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Rezultatet janë vlerësuar me arritjen e një bashkëpunimi më të fortë mes institucioneve pjesëmarrëse dhe në veçanti, përmirësimi i rëndësishëm në ndërgjegjësimin e përgjithshëm në lidhje me rëndësinë dhe funksionimin e sistemit të mbrojtjes së pronësisë intelektuale, kryesisht nga punonjësit e ministrive, policia, doganat, inspektorati tregtar dhe nga të tjerë.

Përgjithësisht, rezultatet e vlerësuara mirë të këtij projekti ishin mes impulseve vendimtare për thellimin dhe përsëritjen e këtij qëllimi. Në 2007, mbi 1000 punonjës të sektorit publik u trajnuan rreth çështjeve vijuese dhe sistemi i informacionit u thellua edhe më tej. Si rrjedhim, u arrit një metodologji e detajuar për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe gjithashtu edhe një përforsim i metodologjisë së bashkëpunimit mes institucioneve aktive në promovimin e këtyre të drejtave. Materialet për mësim u përqëndruan në problemet kryesore në këtë fushë. Si lektorë, morën pjesë ekspertë të njohur, si nga Republika Çeke, ashtu dhe nga vende të tjera.

Një etapë e rëndësishme ishte implementimi i Direktivës Nr. 2004/48/KE të datës 29 prill 2004 sipas rregullit ligjor të Republikës Çeke. Ajo u ekzekutua nëpërmjet një amendamenti të ligjit të të drejtave të autorit dhe Nenit të ri Nr. 221/2006 Coll., për zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale. Ky legjislacion identifikoi saktë personat që mund të pretendojnë për këto të drejta, përmirësoi dhe unifikoi të drejtat e zotëruesve të informacionit rreth shkeljeve të të drejtave të subjekteve, identifikoi mënyrat e mbrojtjes dhe vendosi një mënyrë të re, dhe në shumë raste thjeshtoi gjithashtu mundësitë në lidhje me vlerësimin e sasisë së dëmit për shkeljet e të drejtave të pronësisë intelektuale. Për konfliktet që përfshijnë çështjet e pronësisë intelektuale që lidhen, si me shqyrtimin gjyqësor të vendimeve administrative të Zyrës së Pronësisë Industriale, ashtu dhe të shkeljeve të këtyre të drejtave, të njohura si të tilla në Republikën Çeke, u themelua një gjykatë e shkallës së parë, Gjykata Bashkiake në Pragë

Përvoja me arsimimin në fushën e pronësisë intelektuale

Përvoja me arsimin në fushën e pronësisë intelektuale daton që në vitet '60 të shekullit të kaluar, kur në Universitetin Teknik në Brno për këtë lëndë u zhvillua një kurs pasuniversitar me katër semestra.

Gjatë vitëve shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë, arsimimi në fushën e pronësisë intelektuale në universitete u krye sistematikisht vetëm në Shkollën e Ekonomisë në Pragë, ku kjo lëndë u dha brenda lëndëve të tjera dhe ku ato ishin gjithashtu programe pasuniversitare shkencore me shtrirje të kufizuar, që specializohej për këtë çështje. Në disa universitete si Fakulteti Juridik në Pragë dhe në Brno, arsimimi në fushën e pronësisë intelektuale u krye nëpërmjet mësimin të kësaj lënde gjatë leksioneve individuale brenda subjekteve të ndryshme. Arsimimi në fushën e shpikjeve, novacioneve dhe licencimit në shtrirjen që korrespondon me atë të Shkollës së Ekonomisë në Pragë, në disa prej fakulteteve të Shkollës Teknike në Bratislavë u krye brenda lëndëve individuale. Ky Universitet Sllovak ofroi gjithashtu një program pasuniversitar për një periudhë 15 vjeçare në fushën e shpikjes dhe licencimit që u mbyll me një sërë provimesh shtetërore.

Në ditet e sotme, Kushtetuta dhe Karta e të Drejtave Themelore dhe të Lirive Bazë përfaqësojnë bazën e sistemit të arsimit në Republikën Çeke. E drejta e arsimit është brenda të drejtave themelore të qytetarëve. Koncepti mbi të drejtën për arsimim ka një bazë ndërkombëtare domethënëse, arsimimi do të mbështesë ndërgjegjësimin mbi identitetin kombëtar dhe europian dhe përkatësinë në botë.

Studentet njihen me temën e pronësisë intelektuale në shkollat fillore brenda programeve të studimit për arsimin fillor dhe brenda grupit të masave informuese pedagogjike, që deri më tashmë i referohen “piraterisë kompjuterike”. Departamenti i Arsimit e ka integruar çështjen e kopjeve të paligjshme në informacionin organizativ pedagogjik për shkollat dhe institucionet shkollore. Një nga qëllimet brenda fushës arsimore “Teknologjitë e

Informacionit dhe të Komunikacionit” është respektimi i të drejtave që i përkasin pronësisë intelektuale gjatë përdorimit të programeve kompjuterike. Fusha arsimore “Qënia njëzëzore dhe shoqëria - e drejta civile” përfshin gjithashtu të mësuarit rreth pronësisë dhe zotërimit, dhe kjo përfshin gjithashtu pronësinë intelektuale dhe ruajtjen e saj. Një tekst “Mbrojtja e të drejtës së autorit” që ka një formë të një broshure metodike mund të përdoret gjatë mësimin.

Arsimimi në fushën e pronësisë intelektuale në universitetet publike.

Arsimimi aktual në fushën e pronësisë industriale dhe pronësisë tjetër intelektuale në universitetet publike përfshihet në një shkallë të gjerë në Shkollën e Ekonomisë në Pragë, në Fakultetin Juridik të Universitetit Masaryk në Brno, në Fakultetin Juridik të Universitetit Charles në Pragë dhe në Fakultetin Juridik të Universitetit të Bohemisë Perëndimore në Plzeň (Pilsen). Universitetet ofrojnë gjithashtu programe doktorature të specializuara në çështjet e pronësisë intelektuale. Disa universitete të tjera në Republikën Çeke organizojnë leksione individuale që trajtojnë këto çështje.

Ndërmjet këtyre kolegjeve publike të arsimit të llojit universitar të pronësisë industriale dhe të pronësisë tjetër intelektuale, ndoshta kryhet në shkallë më të gjerë në Shkollën e Ekonomisë në Pragë. Mes lëndëve bazë të VSE së Pragës, që merren me çështjet e pronësisë industriale dhe intelektuale, bën pjesë edhe “Ligji i Pronësisë Intelektuale”. Çështjet e pronësisë industriale dhe ndonjë pronësie tjetër intelektuale shpjegohen brenda lëndës "Ligji i Konkurrencës". Të dyja këto lëndë janë lëndë me detyrim brenda specializimit kryesor “Ligji Tregtar” dhe ato janë gjithashtu pjesë e provimit shtetëror mbi Ligjin e Konkurrencës. Shkolla e Ekonomisë në Pragë ofron gjithashtu vazhdimisht një program të zgjeruar doktorature që specializohet në pronësinë industriale dhe pronësi të tjera intelektuale.

Në Shkollën e Ekonomisë në Pragë, koncepti i aseteve të paprekshme, pronësia industriale dhe intelektuale, teoria dhe domethënia e mbrojtjes ligjore të pronësisë intelektuale, zhvillimi i saj brenda dhe jashtë vendit trajtohen brenda lëndës “Ligji mbi Pronësinë Intelektuale”, që është e detyrueshme ose me zgjedhje për specifikimin kryesor “Ligji Tregtar” dhe për specializimin dytësor "Ligji në Biznes" dhe fakultativ për fushat e tjera.

Në lidhje me të drejtat e autorit, kursi fillon me konceptet e ndryshme të mbrojtjes së të drejtës së autorit jashtë vendit, që ndiqet nga interpretimi i Ligjit Çek në fuqi për të Drejtat e Autorit, ndërkohë që konsiderohen rregulloret ligjore të lidhura dhe përkatëse. Kjo pjesë prezantuese ndiqet më pas nga shpjegimet e pyetjeve që lidhen me të drejtat e autorit mbi veprat, krijimin e veprave të autorit, lidhjen mes të drejtave të autorit dhe të drejtave të pronësisë që i përkasin kryesisht të prekshëm të veprës dhe aksesit në këtë vepër. Pjesët individuale i dedikohen të drejtës së autorit të personalitetit dhe kohëzgjatjes së tyre, mbrojtjen e veprës pas vdekjes së autorit dhe administrimin e përbashkët të të drejtës së autorit dhe gjithashtu të drejtave të pronësisë së autorit, kohëzgjatjes së tyre, përfundimin e së drejtës dhe kufizimit ligjor që lidhet me të drejtën e autorit, si p.sh. përdorimi falas i veprave dhe licenca statusore falas. Kujdes i kushtohet gjithashtu masave mbrojtëse civile në lidhje me të drejtën e autorit. Leksionet merren gjithashtu me punonjësit dhe veprat shkollore, veprat audiovizive dhe veprat që janë përdorur në mënyrë audiovizive. Vëmendje më e madhe i kushtohet Aktit të ri të të drejtave të autorit, që i shkon mbrojtjes ligjore të programeve kompjuterikë dhe bazave të të dhënave.

Çështjet që lidhen me emrin e kompanisë dhe mbrojtjen e saj, emrin tregtar të një biznesmeni që nuk është regjistruar në Regjistrin Tregtar dhe një emri të përbashkët të disa biznesmenëve, janë gjithashtu pjesë e arsimimit.

Brenda marrëveshjeve në fushën e pronësisë intelektuale, kujdes i kushtohet sistemit të këtyre marrëveshjeve, formës ligjore të transferimit të teknologjive, si p.sh. marrëveshjeve për licencat, kontratat ose veprat e paprekshme, marrëveshjeve mbi caktimin e të drejtave që i përkasin aseteve të paprekshme, shitjes së ndërmarrjes në lidhje me pronësinë intelektuale, marrëveshjet për kërkimet e përbashkëta dhe për marrëveshje të tjera që lidhen me marrëveshjet mbi pronësinë intelektuale, si marrëveshjet mbi sekretin tregtar dhe mbi ekspertizën. Çështjet mbi mbrojtjen e reputacionit të mirë të personave juridikë, vullnetin e mirë dhe mbrojtjen e tij, mbrojtjen ligjore të të dhënave personale, përfshirë sistemet e veçanta të mbrojtjes së të dhënave personale, si statistikore, bankare, mjekësore etj. trajtohen brenda pjesës së mbrojtjes ligjore të personit.

Kujdes i kushtohet gjithashtu lidhjes mes të drejtave që i përkasin aseteve të paprekshme dhe ligjit kundër kufizimit të konkurrencës ekonomike (ligji i karteleve), mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, përdorimit të aseteve të paprekshme në internet etj. Çështjet e mbrojtjes ndërkombëtare të së drejtës së autorit në marrëveshjet ndërkombëtare dhe në ligjet e Komunitetit Europian, gjithashtu edhe çështje që lidhen me zbatimin e ligjit përfundimtar, përkatësisht në lidhje me internetin, përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të arsimimit.

Për sa i përket ligjit industrial, ai paraqitet brenda arsimimit nëpërmjet shpjegimit të pyetjeve të lidhura me mbrojtjen ligjore të shpikjeve, dizajneve utilitare, dizajneve industriale, topografisë së produkteve gjysmëpërcjellëse, shpikjeve në bioteknologji, propozimeve të racionalizimit, varieteteve të reja të bimëve dhe racave të kafshëve. Brenda të drejtave që i përkasin qëllimeve, kujdes i kushtohet kryesisht markave tregtare, emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografikë, informacionit mbi origjinën e mallrave, emërtimet gjenerike, logos dhe mbrojtjes së saj dhe emërtimeve të tjera të regjistruara ose të paregjistruara.

Të drejtat industriale që mund të merren në bazë të proceseve të kryera nga Zyra Çeke e Pronësisë Industriale, trajtohen nga klasifikimi i tyre brenda një sistemi të kërkuar nga marrëveshjet e pranishme ndërkombëtare, kushtet e mbrojtjes së tyre, të drejtat kur kjo mbrojtje mund të jepet dhe mënyra e aplikimit dhe proceseve të tyre për mbrojtje ligjore. Kujdes i veçantë i kushtohet të drejtave të zotëruesve të tyre, pasi jepet mbrojtja ligjore, kufizimi i efekteve të kësaj mbrojtjeje, përfundimi, betimi, zbatimi i këtyre të drejtave. Arsimimi trajton gjithashtu lidhjen mes mbrojtjes së markave tregtare, emrave tregtarë ose personave në lidhje me emrat e domeneve dhe internetin. Kur merreni me zbatimin e lëndëve të të drejtave të pronësisë industriale jashtë vendit, leksionet trajtojnë si zbatimin sipas mënyrës kombëtare dhe gjithashtu në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare. Përveç procedurave klasike të bazuara në Konventën e Parisit mbi Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe në Marrëveshjen e Madridit në lidhje me Regjistrimin Ndërkombëtar të Markave, vëmendje i kushtohet gjithashtu aplikimeve sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Patentat, Protokollit që lidhet me Marrëveshjen e Madridit dhe Konventën Europiane të Patentave, aplikimet e një marke tregtare të Komunitetit.

Gjatë këtyre leksioneve, vëmendje i kushtohet gjithashtu literaturës së patentave dhe markave tregtare, kërkimeve, përfaqësimit përpara Zyrës së Pronësisë Industriale. Këto leksione ndiqën më pas në semestrin tjetër brenda lëndës “Ligji i Pronësisë Intelektuale”, sipas lëndës “Pronësia industriale dhe licencat në biznes” që zbaton një koncept seminare për të fituar

përvojë praktike dhe më të thellë kur merret dhe zbatohet mbrojtja e pronësisë industriale. Në këtë lëndë, studentet kalojnë situata model që mund të dalin kur zbatohen të drejtat individuale të pronësisë industriale, gjatë proceseve të aplikimit, gjatë proceseve të evidentimit, ata kalojnë llojet individuale të marrëveshjeve për krijimin e veprave dhe zgjidhjeve që mund të zbatohen si lëndë e mbrojtjes së pronësisë industriale. Pjesët individuale i dedikohen çështjeve që lidhen me programet kompjuterike, jo vetëm atyre që i përkasin marrëveshjeve në krijimin e tyre, por gjithashtu përdorimit në praktikë dhe marrëdhënieve kontraktuese që ngrihen kur përdoren lëndët e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale ose të drejtave të tjera të pronësisë intelektuale. Çështjet sesi kryhen kërkimet në literaturën e patentave dhe markave tregtare nuk lihen anash.

Si "E drejta e pronësisë intelektuale", ashtu edhe "Pronësia industriale dhe licencat në biznes" janë pjesë e fushës së lëndëve me zgjedhje të këtyre studimeve të specializuara në "Vlerësimin e ndërmarrjeve dhe pasurive të saja" që ofrohen nga instituti i vlerësimit bazuar në VŠE për të interesuarit në veprimtaritë e ekspertëve dhe vlerësuesve të specializuar në vlerësimin e ndërmarrjeve dhe lëshimin e një certifikatë me qëllim emërimin e ekspertëve dhe të vlerësuesve të pasurive të ndërmarrjeve.

Lënda "Ligji për kompjuterin dhe informacionin" që kryhet në Shkollën e Ekonomisë në Pragë, e detyrueshme ose me zgjedhje për disa nga specializimet gjatë studimeve të inxhinierisë në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Statistikave dhe me zgjedhje për fushat e mbetura në VŠE kryesisht për specializimet parësore si "E drejta tregtare" dhe specializimet dytësore "E drejta në biznes" bazohen kryesisht në ligjin çek të së drejtës së autorit për direktivën e programeve kompjuterikë dhe direktivave të tjera përkatëse, duke përfshirë direktivat dhe problemet që kanë të bëjnë tregtinë elektronike dhe nënshkrimin elektronik. Sigurisht që duke marrë parasysh rregulloret e tjera ligjore të zbatueshme në fushën e mbrojtjes së pronësisë industriale duke përfshirë konkurrencën e padrejtë në këtë fushë. Gjatë këtyre leksioneve studiohen vendimet e huaja më të rëndësishme të disponueshme që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të programeve kompjuterike.

Për sa i përket softuerëve, aktualisht mbrojtja bazohet kryesisht në dispozitat e ligjit të të drejtave të autorit, që konsideron si vepër dhe një program kompjuterik pavarësisht formës së realizimit të tij, duke përfshirë materialin përgatitor mbi konceptimin, duke u siguruar origjinalitetin e tij që nënkupton të qenit krijim intelektual i vetë autorit. I kushtohet vëmendje e jashtëzakonshme profesionit të ardhshëm të studentëve kushtuar të drejtave të autorit të programeve kompjuterike dhe punonjësve të tyre. Po shqyrtohen qasje të ndryshme dhe mënyra për mbrojtjen e programeve kompjuterike me anë të patentave dhe dizajneve të përdorimit.

Gjatë leksioneve dhe seminareve i kushtohet vëmendje gjithashtu regjistrimit të emrave të domeneve në lidhje me markat tregtare dhe konkurrencës së padrejtë dhe hapave të mundshëm që mund të ndërmerren nëse janë regjistruar nga një individ i paautorizuar. Aspekti ligjor i nënshkrimeve elektronike dhe tregtia elektronike përbën këtu një pjesë të rëndësishme të leksioneve.

Rëndësia dhe kompleksiteti jo i vogël i arsimimit në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale në Shkollën e Ekonomisë në Pragë, vihen në pah nga fakti që provimet e shtetit për studentet me specializimet parësore në "Të drejtën tregtare" ndahen në dy pjesë ku njëra përfaqësohet nga pronësia intelektuale dhe ligji për konkurrencën (dhe e dyta nga letrat me

vlerë dhe tregu kapital). Çdo vit, afërsisht një e treta e studentëve në këtë specializim zgjedhin pjesën e pronësisë intelektuale dhe ligjin për konkurrencën.

Gjithashtu dhe arsimimi shkollor po përparon me sukses brenda fushës të doktoraturës dhe programit tre dhe pesë vjeçar të specializuar në fushën e pronësisë industriale dhe të pronësive të tjera intelektuale. Aktualisht ka një program për doktoraturë në studimet e larta në fushën e tregtisë elektronike, të drejtave të autorit që kanë të bëjnë me internetin, zhvillimi i marrëdhënieve në fushën e të drejtës së markave tregtare dhe marrëdhënieve ligjore në fushën e transferimit të teknologjive.

Fakulteti Juridik i Universitetit Charles në Pragë ka qënë aktiv në arsimimin për fushën e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale për shumë vitë përmes institutit të së drejtës së autorit, të drejtës industriale dhe ligjit për konkurrencën. Instituti u themelua në 1967 dhe që atëherë ka qënë një vend studimor që merret në mënyrë intensive me kërkimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen individuale dhe përdorimin social të rezultatëve të veprimtarive intelektuale në fushat e caktuara.

Në veprimtaritë pedagogjike, arsimimi përfshin lëndë të detyrueshme si dhe lëndë me zgjedhje. Brenda fushës së lëndëve të detyrueshme: E drejta civile themelore, mbahen tre leksione dhe numrin përkatës i seminareve për pyetjet në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale.

Aktivitetet kryesore pedagogjike janë dy lëndë me zgjedhje që është baza e të drejtës së pronësisë intelektuale dhe të drejtës së autorit dhe të drejtës industriale në shoqërinë e informacionit. Në bazën e të drejtës së pronësisë intelektuale, studenti mëson rreth sistemit të pasurive të paprekshme, të terminologjinë e përgjithshme në lidhje me të drejtën e autorit, rreth të drejtës së patentës dhe të drejtave të tjera të pronësisë industriale duke përfshirë traktatet ndërkombëtare. Këto orë zhvillohen gjatë nivelit të tretë ose të pestë gjatë gjithë semestrit dhe janë në formën e leksioneve të rregullta prej dy orësh çdo javë dhe mbyllet me një provim me shkrim.

Lënda “Ligji mbi të drejtën e autorit” dhe “E drejta industriale në shoqërinë e informacionit” lidhet me lëndën e mëparshme dhe objektivi i saj është sigurimi i një përmbledhje të plotë të situatës aktuale në fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave industriale. Gjatë orëve trajtohen dhe pyetje që kanë të bëjnë me prirjet e reja të karakterit ndërkombëtar, specializohet në çështje që kanë të bëjnë me të drejtën e autorit dhe internetin, mbrojtjen ligjore të ruajtjes së të dhënave, mbrojtja e patentës nga shpikjet bioteknologjike dhe synimeve të inxhinierisë gjenetike. Mbulon gjithashtu dhe mjetet për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale duke përfshirë piraterinë dhe tregtinë e mallrave të falsifikuara.

Për tëzën e tyre studentet mund të zgjedhin tema të llojeve të ndryshme që kanë të bëjnë me çështjet e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale. Brenda fushës së studimeve të doktoraturës, veprimtaritë pedagogjike përqëndrohen në çështjet që kanë të bëjnë me ligjet e Bashkimit Europian për pasuritë e paprekshme.

Veprimtaritë pedagogjike janë prezentë në një shtrirje të ngjashme në universitetet e tjera të drejtësisë, kryesisht në Fakultetin Juridik të Universitetit të Brno dhe Universitetin e Bohemisë Perëndimore në Pilsen.

Arsimimi në fushën e pronësisë intelektuale në institutin e IPO-s

Instituti i trajnimeve për pronësinë industriale në Zyrën e Pronësive Industriale ka ofruar arsimim të specializuar në fushën e të drejtave të pronësisë industriale për një periudhë të gjatë kohë. U themelua me dekret të Departamentit të Arsimit në 1963 dhe mësimi filloi në shtator të këtij viti dhe vazhdon akoma. Ky program arsimimi është kryer me sukses nga më shumë se 3500 studentë. Ky kurrikulum është ndryshuar disa herë gjatë vitëve dhe programi origjinal tre vjeçar u shkurtua në një program dy vjeçar. Aktualisht mendohet që të diplomuarit e universitetit gjatë karrierës së tyre të merren me çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave industriale, individë të interesuar në për t'u bërë avokatë të patentave dhe për nëpunësit e rinj të Zyrës së Pronësisë Industriale. Gjatë orëve trajtohen baza e të drejtave të autorit dhe të drejtës administrative, ligjin për patentat, treguesit gjeografikë/emërtimet e origjinës dhe dizajnet industrialë. Çështjet që kanë të bëjnë me informacioni mbi patentat trajtohen gjithashtu gjatë orëve, praktikohen të gjitha llojet e kërkimeve industrialo-ligjorë, studentet njihen me ruajtjen e të dhënave të huaja dhe të gjitha llojet e burimeve e informacionit elektronik. Gjatë orëve trajtohen gjithashtu traktatet ndërkombëtare dhe e drejta europiane që ka të bëjë me mbrojtjen e pronësisë intelektuale. Procedurat kundërshtuese, strategjitë industriale-ligjore dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale i drejtohen subjekteve të veçanta. Ky program arsimimi mbulon 320 orë mësimi. Studentet marrin kreditet dhe provimet në fund të çdo semestri. Studentet shkruajnë dhe mbrojnë një tezë dhe ju bëhet një provim përfundimtar në fund të çdo programi. Studentëve iu sigurohet literaturë profesionale në klasat individuale.

Program i studimeve të pavarura universitare në fushën e pronësisë industriale në Universitetin Metropolitan në Pragë.

Gjatë gjithë jetëgjatësisë së Institutit të Trajnimit mbi Pronësinë Industriale në Zyrën e Pronësisë Industriale është diskutuar për mënyrën e përfshirjes së studimeve të kësaj fushë në sistemin e studimeve universitare. Pas këshillimeve midis Universitetit privat të Administrimit Publik dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Pragë (që sot quhet Universiteti Metropolitan) dhe Zyrës së Pronësisë Industriale të Republikës Çeke, detyra e së cilës është dhënia e mbrojtjes ligjore subjekteve të pronësisë industriale, mbledhja dhe mundësimi i dokumentacionit për patentat dhe markat tregtare dhe sigurimi i veprimtarive që kanë të bëjnë me autoritetin e Dhomës së Avokatëve të Patentave, duke përfshirë sigurimin e aktiviteteve ndërkombëtare në këtë fushë, në vitin 2002 u arrit në përfundimin se do të ishte e dobishme që në Republikën Çeke të krijohet, brenda fushës së specializimit për drejtësi, në këtë universitet, një program studimi i pavarur i nivelit të parë "Pronësia Industriale".

U pranua se Zyra e Pronësisë Industriale të Republikës Çeke, që përbën një organ qëndror në administratën e shtetit, ka një interes të lartë në përmirësimin e kualifikimeve të specialistëve që sigurojnë procedurat ku ju jepet mbrojtje ligjore patentave, dizenjove industriale, dizenjove të përdorimit, markave tregtare dhe emërtimeve të origjinës në këtë Zyrë dhe jo vetëm në lidhje me nëpunësit e administratës së shtetit por dhe me specialistë si avokatet e patentave dhe markave tregtare që përfaqësojnë palët gjatë këtyre procedurave.

Në lidhje me përgatitjet e mëparshme për anëtarësimin e Republikës Çeke në Bashkimin Europian, anëtarësimin në Konventën Europiane në fushën e Patentave dhe themelimin e Zyrës për Harmonizimin e Tregut të Brendshëm, përpara të cilave qëndrojnë pezull procedurat në lidhje me markat tregtare komunitare dhe dizenjot e regjistruar komunitarë, po

rritën akoma më shumë kërkesat ndaj këtyre specialistëve. Nuk ka të bëjë thjesht me rritjen e kërkesave ndaj njohurive të këtyre specialistëve për sa i përket mbarë fushës së të drejtave të pronësisë industriale në nivel ndërkombëtar, por gjithashtu edhe për njohuritë që kanë të bëjnë me statusin e zgjidhjes së këtyre çështjeve në botë, këto kohë e fundit, e në veçanti në lidhje me prirjet për harmonizimin dhe integrimin në shtetet e Bashkimit Europian.

Zgjidhja e problemeve në lidhje me mbrojtjen ligjore të pronësisë industriale parashtron kërkesat për njohuri të parimeve themelore ligjore të teorisë së të drejtës dhe filozofisë ligjore, njohuritë bazë mbi të drejtën civile, të drejtën tregtare, ligjin për konkurrencën, njohuritë bazë mbi ligjin për procedurat civile, të drejtën administrative dhe organizimin e shërbimit publik dhe ekonomik për specialistët që kryejnë këto detyra.

Në lidhje me rritjen e marrëdhënieve ndërkombëtare u bë e nevojshme që këta specialistë të kishin një vështrim të përgjithshëm të evoluimit të mendimit europian gjatë periudhës së fundit dhe njohuri shumë të mira të institucioneve dhe proceseve të vendimmarrjes në Bashkimin Europian, integrimin ekonomik europian në lidhje me fushën e pronësisë industriale dhe pronësisë tjetër intelektuale dhe të ishin në gjendje të përfitonin nga gama e pasur e vendimeve europiane. Ata duhet të jenë të aftë të përgatisin aplikimet për mbrojtjen e shpikjeve, dizenjove industriale, modeleve të përdorimit, markave tregtare, emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografikë dhe për këtë arsye është e nevojshme të përqëndrohet arsimi i tyre edhe në përpunimin e këtyre aplikimeve dhe të procedurave, si përpara zyrës kombëtare, ashtu edhe përpara zyrave të huaja. Specialistët e kësaj fushë duhet të jenë të pajisur mirë me njohuritë bazë mbi të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të si dhe me ligjin për konkurrencën, të cilat lidhen ngushtë me fushën e pronësisë industriale.

Marrëdhënie ndërkombëtare që po integrohen akoma më shumë në procedurat mbi mbrojtjen ligjore të të drejtave të pronësisë industriale, si dhe informacioni në gjuhë të huaja në fushën e të drejtave të pronësisë industriale rrisin kërkesat për aftësi të mira gjuhësore nga ana specialistëve të cilët merren me këto procedura. Eksperienca mbarë botërore na tregon për nevojën e njohurive të mira gjuhësore në të paktën dy gjuhë.

Për sa i përket programeve arsimore, i është kushtuar vëmendje e veçantë procedurave për mbrojtjen e patentave në Zyrën Europiane të Patentave në Mynih sipas Konventës Europiane në Fushën e Patentave, si dhe procedurave të markave tregtare komunitare në Zyrën e Harmonizimit të Tregut të Brendshëm. Kjo supozon gjithashtu njohuri të hollësishe mbi konventat ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale dhe pronësisë intelektuale, si dhe njohuri mbi ligjin për patentat dhe markat europiane dhe komunitare, duke përfshirë vendimet e zbatueshme. Në nuk mund të injorojmë parimet e përgjithshme të zbatimit të të drejtave të pronësisë industriale në pjesë të tjera të botës, sidomos në Sh.B.A dhe Japoni dhe në grupimet e tjera rajonale të integritit, për shëmbull në sistemin euroaziatik të patentave ose në grupime të ngjashme në Afrikë. Vëmendje e veçantë i kushtohet sistemeve të informacionit për patentat dhe markat tregtare dhe përdorimit të këtyre sistemeve gjatë kërkimeve, veçanërisht përdorimit të sistemeve elektronike të kërkimit.

Në lidhje me faktin e të qenit e nevojshme që programi i propozuar i studimeve për pronësinë industriale të jetë i hapur për nëpunësit, të cilët janë aktivë tashmë në këtë fushë bashkë me organet e administratës së shtetit, institucione dhe organizata të tjera, ndërmarrje industriale dhe tregtare si dhe avokatet e patentave dhe markave tregtare, përveç studimeve me kohë të plotë është propozuar dhe një formë e ndërthurur e studimeve (në distancë) për këtë program akademik.

Kursi i parë i programit të studimeve të nivelit të parë për "Pronësinë Industriale" në këtë universitet u hap gjatë vitit akademik 2002-2003 dhe në të u pranuan 27 studentë. 22 prej këtyre studentëve mbaruan studimet e tyre në 2005-ën bashkë me provimin përfundimtar shtetëror dhe mbrojtjen e tezës. Numri i studentëve që po pranohen në këtë program studimesh është rritur në vitet pasuese dhe shkon nga 30 deri në 45 studentë.

Tre vitë eksperiencë me këtë arsimin akademik të një programi të veçantë studimesh treguan se qëndrimet ndaj planifikimit ishin të sakta. Brenda një periudhe të shkurtër kohë u arrit të sigurohej një proces mësimor me mjetet e nevojshme ndihmëse, si: literaturën e disponueshme, tekstet dhe shënimet gjatë leksioneve dhe me anë të internetit dhe rrjetit të kompjuterave të shkollës. Rezulton se studentet marrin njohuri të përgjithshme dhe themelore profesionale të mjaftueshme në fushën e zhvillimit të mbrojtjes ligjore industriale, teorisë së të drejtës dhe filozofisë ligjore, njohuri bazë mbi të drejtën civile, të drejtën tregtare, ligjin për konkurrencën, të drejtën administrative, ligjin për procedurat civile, të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, njohuritë bazë mbi ekonominë, teknologjinë e informacionit, integrimi ekonomik europian dhe aftësi shumë të mira gjuhësore. Për sa i përket njohurive dhe aftësive të specializuara, studentet marrin njohuri shumë të mira në mbrojtjen ligjore industriale, ligjin për patentat dhe markat tregtare, konventat ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes ligjore të pronësisë industriale dhe intelektuale, ligjin për patentat dhe markat komunitare, administrimin e të drejtave industriale, duke përfshirë vlerësimin, dhënien e licencave, transferimin dhe të drejtën e mbajtjes së pronësisë.

Studimet nuk u interesojnë vetëm ekspertëve në sektorin privat të fushës së mbrojtjes së pronësisë intelektuale, por gjithashtu të fushave të tjera, si doganat, inspektimi tregtar dhe policia dhe si rrjedhim edhe çështjet e së drejtës penale dhe çështjet për zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale dhe të drejtave të tjera të pronësisë intelektuale në kufi që kanë të bëjnë me falsifikimin dhe falsifikimet dhe imitimet bëjnë pjesë në edukim. Prandaj mund të pohohet me të drejtë se të diplomuarit do të jenë të përgatitur për të praktikuar jo vetëm në fushën e të drejtave të pronësisë industriale, por edhe në fushën e administrates shtetërore dhe publike, doganave, policisë, për praktikë në ndërmarrjet industriale dhe tregtare, për kryerjen e punës së specializuar në këtë fushë dhe në të tjera.

Në Universitetin Metropolitan të Pragës, i cili ofron programin e studimeve të nivelit të parë për mbrojtjen ligjore të pronësisë industriale, aktualisht po studiojnë pothuajse pesë mijë studentë në një sërë programesh mastër dhe studimeve të nivelit të parë. Duke qënë se është një universitet privat, studimi bëhet kundrejt pagesës, e cila mund të krahasohet me pagesat në universitetet e tjera privatë të Republikës Çeke. Ky universitet mori akreditim nga Ministria e Arsimimit e Republikës Çeke edhe për programin e studimit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Rajonale në Pronësinë Industriale, si për studimet me kohë të plotë ashtu edhe për mënyrën e kombinuar (në distancë). Prandaj, që nga viti akademik 2006 të diplomuarit në programin e studimit të nivelit të parë në fushën e pronësisë industriale kanë mundësinë të vazhdojnë këtë program mastëri dy vjeçar. Programet e studimit të nivelit mastër në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe rajonale në pronësinë industriale mund të ndiqen edhe nga të diplomuarit në programet studimore të nivelit të parë të kryera në universitete të tjera privatë, publike dhe shtetërore, si dhe nga të diplomuarit nga universitetet e tjera të zakonshme si ai teknik, i ekonomisë dhe juridik, p.sh. inxhinierët që duan të thellojnë njohuritë e tyre në fushën e mbrojtjes ligjore të të drejtave të pronësisë industriale dhe të drejtave të tjera të pronësisë intelektuale.

Përmbajtja e studimeve në semestrat e veçantë të programit të studimeve të nivelit mastër, siç janë pranuar *de facto* nga deklarata pozitive e Komitetit të Akreditimit të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportëve të Republikës Çeke me kërkesë akreditimit të këtij programi studimi të nivelit mastër në të dyja format si atë të ndërthurur dhe atë me kohë të plotë, në themel përfshin si kurset në studimet ndërkombëtare dhe kombëtare në përgjithësi edhe kurset për të drejtat e pronësisë industriale dhe të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale.

Dy semestrat e parë të programit të studimeve të nivelit mastër përfshijnë kurse të përgjithshme arsimore dhe teorike, si për shëmbull prezantimin e studimeve të marrëdhënieve ndërkombëtare, teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, kuadrin institucional të integritimit evropian dhe integritimin ekonomik evropian. Por që vitin e parë të studimeve ka kurse që përqëndrohen në drejtësi, si për shëmbull: sistemi gjyqësor evropian, ligji antitrust dhe marrëdhëniet midis konkurrencës së padrejtë dhe të drejtave të pronësisë industriale. Këto shoqërohen nga kurse me orientime specifike me baza më të gjera shkencore si për shëmbull: mbrojtja kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare e pronësisë industriale, mbrojtja ndërkombëtare e patentave, sistemi evropian dhe euroaziatik i patentave, sistemi anglo-amerikan dhe afrikan për mbrojtjen e pronësisë intelektuale.

Viti i dytë i këtij programi të studimeve mastër përqëndrohet kryesisht në kurset në fushën e të drejtave dhe marrëdhënieve të pronësisë industriale të tilla si zgjidhja e mosmarrëveshjeve mbi të drejtat e pronësisë intelektuale, sistemet ndërkombëtare të informacionit industrial ligjor, aspektet e veçanta të ligjit Çek për patentat dhe markat tregtare, vlerësimi i të drejtave të pronësisë intelektuale, ligji për reklamat dhe vendimet në lidhje me patentat, markat tregtare dhe dizenjot. Gjithsesi, në pjesën e dytë të studimeve ka kurse ndër-sektoriale dhe teorike si për shëmbull: marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare dhe detyrimet e tregtisë.

Rumani

Sigurimi i mbrojtjes së pronësisë intelektuale në Rumani është detyrë e dy institucioneve të specializuara: Zyres Shtetërore për Shpikjet dhe Markat – në fushën e pronësisë industriale, dhe Zyres Rumune për të Drejtën e Autorit – në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të.

Zyra Shtetërore për Shpikjet dhe Markat është organi i specializuar i administratës qendrore publike, i cili i përgjigjet qeverisë, si autoriteti i vetëm që siguron mbrojtjen e pronësisë industriale, i cili përpunon dhe i paraqet qeverisë për miratim strategjinë për zhvillimin dhe mbrojtjen e pronësisë industriale në Rumani dhe zbaton politikën e qeverisë në këtë fushë. Zyra Rumune për të Drejtën e Autorit është organizuar si një organ i specializuar që i përgjigjet qeverisë, me autoritetin e vetëm në territorin rumun për sa i përket provave, vëzhgimit dhe kontrollit të zbatimit të ligjit në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të.

Përpara aderimit të vendit në BE, institucionet e përfshira në përpunimin e strategjisë kombëtare në fushën e pronësisë intelektuale në Rumani ishin: Zyra Shtetërore për Shpikjet dhe Markat, Zyra Rumune për të Drejtën e Autorit, Ministria e Teknologjisë së Komunikacionit dhe të Informacionit, Ministria e Arsimit, Kërkimeve dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe Kooperativave, Autoriteti Kombëtar i Drejtorisë së Doganave, Autoriteti Kombëtar për Mbrojtjen e Konsumatorit, Ministria e

Drejtësisë, Ministria Publike, Ministria e Brendshme dhe e Administrimit, Ministria e Integritimit Europian, Ministria e Puneve të Jashtme, Ministria e Ekonomisë dhe Tregtisë, Dhoma Kombëtare Rumune e Avokatëve të Patentave, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Rumanisë dhe Bukureshtit. Politika e qeverisë në fushën e kërkim-zhvillimit dhe risive synon shtimin e proceseve novatore dhe përmirësimin e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga ndërmarrjet rumune.

Instrumenti i përdorur për zbatimin e kësaj politike qeveritare është Plani Kombëtar për Kërkimet, Zhvillimin dhe Risitë, i koordinuar nga Ministria e Arsimit, Kërkimeve dhe Rinisë. Me ngritjen e Ministrisë së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe Kooperativave me Vendim Qeverie, u arrit njohja e funksionit ekonomik dhe social që ka ky sektor në zhvillimin ekonomik të vendit. Si rezultat i procesit të riorganizimit të qeverisë, aktiviteti i kësaj Ministrie i ka kaluar Agjencisë Kombëtare të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe Kooperativave, e cila i përgjigjet qeverisë dhe koordinohet drejtpërdrejt nga Kryeministri. Agjencia Kombëtare e ka marrë këtë aktivitet nga Ministria e NVM-ve dhe Kooperativave, duke ruajtur atributet dhe përgjegjësitë e saj kryesisht për sa i përket zhvillimit të strategjisë dhe politikave të nxitjes së zhvillimit të NVM-ve, ngritjes, zbatimit dhe monitorimit të programeve për sektorin e NVM-ve dhe zhvillimit të legjislacionit në këtë fushë.

Për sa i përket aktiviteteve të mbikqyrjes së tregut në përgjithësi, këto janë plotësisht në duart e policisë rumune, Zyrës për të Drejtën e Autorit, Autoritetit Kombëtar për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe pjesërisht në duart e Autoritetit të Doganave. Megjithatë, me përjashtim të Zyrës për të Drejtën e Autorit, nuk ka asnjë organ të veçantë administrativ që përqendrohet vetëm në mbikqyrjen e tregut në fushën e PI-së. Autoriteti Kombëtar për Mbrojtjen e Konsumatorit (NACP) “koordinon dhe realizon strategjinë dhe politikën e qeverisë rumune në lidhje me zbatimin e mbrojtjes së konsumatorit në vend, parandalimin dhe luftimin e praktikave që paragjykojnë jetën, shëndetin, sigurinë ose interesat ekonomikë të konsumatorëve dhe vlerëson efikasitetin e sistemit të mbikqyrjes së tregut për produktet dhe shërbimet e ofruara” (shikoni gjithashtu www.anpc.gov.ro). Pra NACP-ja luan të njëjtin rol që luan Inspektorati i Tregut në Republikën Çeke, siç propozohet për autoritetin e ri administrativ në Shqipëri: Autoriteti monitoron dhe inspekton tregun në lidhje me sigurinë e konsumatorëve dhe mbrojtjen e shëndetit. Brenda aktiviteteve të tij inspektuese, Autoriteti monitoron gjithashtu shkeljet e mundshme të PI-së, të cilat zakonisht lidhen shumë ngushtë me sigurinë e konsumatorëve dhe mbrojtjen e shëndetit.

Prandaj modeli rumun është i ngjashëm me atë çek dhe po kjo zgjidhje është propozuar edhe për Shqipërinë.

Kroaci

Në Kroaci, Zyra Shtetërore për Pronësinë Intelektuale (SIPO) është një institucion thelbësor i sistemit kombëtar të PI-së dhe lidhjes së tij institucionale me sistemin ndërkombëtar të pronësisë intelektuale, në veçanti me institucionet përkatëse europiane (ZEP dhe OHIM) dhe botërore (WIPO dhe WTO), si dhe me zyrat në vend të Shteteve Anëtare të shumë organizatave ndërqeveritare. SIPO është përgjegjëse për zbatimin e shumicës së dispozitave të parashikuara në 25 konventa dhe traktatë shumëpalëshe ndërkombëtare, dhe të të gjitha dispozitave të parashikuara në 15 marrëveshje dypalëshe për bashkëpunimin në fushën e pronësisë intelektuale.

Administrata Doganore brenda Ministrisë së Financës është organizuar me qëllim që të plotësojë kërkesat komplekse të regjimit të ri sipas BE-së dhe Bashkimit Botëror të Doganave. Në këtë riorganizim, doganat janë mbështetur nga një projekt binjakëzimi me Autoritetin Doganor Austriak. Administrata Doganore ka implementuar dhe ka zbatuar plotësisht masat që lidhen me të drejtat e pronësisë intelektuale që nga viti 2007.

Ndjekja penale në Kroaci është në duart e prokurorisë. Brenda reformës së përgjithshme të sistemit gjyqësor, është diskutuar përqëndrimi i ndjekjes së shkeljeve penale në lidhje me shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale në prokuroritë kompetentë për katër gjykatat e bashkive përkatëse – Zagreb, Rijeka, Split dhe Osijek, në mënyrë të ngjashme me përqëndrimin e procedurave civile në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale në gjykatat që trajtojnë çështjet tregtare në Zagreb, Rijeka, Split dhe Osijek. Reforma ka mbetur pezull.

Inspektorati i Shtetit është një organ i veçantë i administratës shtetërore, i cili i përgjigjet direkt qeverisë së Republikës së Kroacisë. Për shkak të pozicioni të tij, puna e inspektimit mund të përqëndrohet më shumë në një vend, kushtet e punës janë përmirësuar, niveli i ekspertëve të inspektimit është ngritur, bashkëpunimi dhe bashkërendimi mes inspektimeve të ndryshme është përmirësuar dhe kostot e kryerjes së inspektimeve të shumta në të njëjtin objekt janë reduktuar. Inspektorati bashkëpunon me ministri të tjera dhe organizata administrative shtetërore dhe bën propozime në organet qeveritare në lidhje me ndryshimet e ligjeve ose tërheq vëmendjen të mangësitë e rregulloreve që reduktojnë efikasitetin e mbikqyrjes së inspektimit, me qëllim përmirësimin e performancës së tij. Shtrirja e detyrave të Inspektoratit të Shtetit përfshin inspektimin në fushat administrative të tregtisë dhe zejtarisë, punës dhe sigurisë në punë, minierave, enëve me presion, rritjes së bagëtisë, industrisë së peshkimit, biznesit të verës, pyjeve, gjuetisë, furnizimit me ushqim dhe turizmit. Inspektorët e Inspektoratit të Shtetit kryejnë detyrat e tyre të mbikqyrjes në përputhje me ligjet që rregullojnë mbikqyrjen dhe inspektimin për fusha të veçanta administrative si dhe me kushtet që duhet të përmbushin inspektorët. Ata janë caktuar në pozicionet e mëposhtme: inspektor i çështjeve ekonomike, inspektor i punës, inspektor i furnizimit me energji elektrike, inspektor i industrisë së minierave dhe inspektor i enëve me presion. Gjatë inspektimit, inspektorët janë të pavarur dhe ndjekin procedurën, marrin vendime dhe masa brenda kuadrit të rregulloreve ligjore, detyrave dhe autoriteteve në zbatim të ligjit dhe rregulloreve të tjera. Për shkak të ndryshimeve të përfshira në ligjin “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”, Inspektorati i Shtetit nuk e kontrollon më performancën publike të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit. Praktika e re përputhet me sistemin kroat të zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale. Megjithatë, kontrolli i mundur në të shkuarën ka kontribuar në një zbatim më të mirë të të drejtave dhe e ka lehtësuar punën për Shoqatat e Administrimit Kolektiv. Ndërkohë, Inspektorati i Shtetit është ngritur brenda shërbimit të inspektimit të veprimeve tregtare, një departament i specializuar për pronësisë intelektuale, i cili ndihmon në monitorimin e tregut dhe në zbulimin e rasteve të shkeljeve të PI-së. Megjithatë, puna e Inspektoratit të Shtetit përqëndrohet kryesisht në fusha të tjera dhe mbrojtja e PI-së mbëtet vetëm një çështje dytësore. Janë bërë propozime për forcimin e kompetencave të tij në fushën e PI-së dhe ndryshimet e dispozitave ligjore përkatëse janë ende në vazhdim.

Përveç autoriteteve të lartpërmendura, vetëm policia kroate luan një rol thelbësor në zbatimin e të drejtave të PI-së.